



Ministri Pirro Vengu: 500 trupa shqiptare në misionet jashtë vendit

Shqipëria linjëzohet 100% me politikën e jashtme të sigurisë së BE-së



» faqe 3



Përfundoi me sukses stërvitja dimërore "Mburoja Albane 33-25" në Voskopojë, Korçë

Trupat e Batalionit III të Këmbëorisë së Jugut të Forcës Tokësore, zhvilluan në rajonin e Voskopojës në Korçë, stërvitjen dimërore 72-orëshe "Mburoja Albane 33-25". Qëllimi i kësaj stërvitje ishte dislokimi i trupave të Batalionit III të Këmbëorisë nga rajoni i përhershëm në rajonin...



faqe 2



IN MEMORIAM
'Tragjedia e Fekenit', dëshmi e sakrificës sublime

Tragjedia e stërvitjes dimërore e 6 shkurtit 1981 ishte një ngjarje e shkruar në memorien e gjithë ushtarakëve shqiptarë, por edhe më gjerë. Ishin tre oficerë dhe tetë studentë të ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, që në kujtesën shqiptare quhen "11 dëshmorët e Meçekut"...



faqe 4



FA, HISTORI SUKSESI
PU, reparti elitë në historikun e tij 33-vjeçar

Policia Ushtarake festoi 33-vjetorin e krijimit të saj. Përgjatë 33 viteve të historisë së saj, Policia Ushtarake ka treguar se është një nga repartet elitë të Forcave tona të Armatosura. Ruajtja e rendit ushtarak, garantimi i zbatimit të ligjit, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe...



faqe 6



Vizitë zyrtare e komandantit të Forcës Tokësore në Greqi

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia zhvilloi një vizitë zyrtare në Athinë, me ftesë të komandantit të Forcës Tokësore të Greqisë gjenerallejtënant Georgios Kostidis.

Takimi u zhvillua në një frymë reciproke bashkëpunimi me temë diskutimin e rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm të aktiviteteve dypalëshe ushtarake të vendeve respektive.

Vizita vijoi më pas në Akademinë Ushtarake të Forcës Tokësore greke, ku trajnohen edhe oficerë shqiptarë që studiojnë atje me të cilët pati edhe një takim të veçantë e të ngrohtë. Më pas u vizitua Shkolla e Trupës së Xhenios ku u pa nga afër një demonstrim i veprimeve EOD, C-IED dhe veprime në mbështetje të katastrofave natyrore që nga tërmetet, përmbytjet dhe zjarret.

Gjeneral major Xhebexhia falënderoi palën greke për mbështetjen e deritanishme duke ritheksuar nevojën për rritjen e bashkëpunimit midis Forcës Tokësore shqiptare e asaj greke në të ardhmen e afërt.

E gjithë vizita u krye në një frymë të lartë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi në funksion të rritjes së trajnimeve, aktiviteteve të përbashkëta stërvitore e kurseve të ndryshme. Këto aktivitete të përbashkëta do të bëjnë të mundur rritjen e besimit ndërmjet dy forcave dhe forcimin e marrëdhënieve si dhe mundësi zhvillimi të kapaciteteve që Forca Tokësore po ndërton, përballë sfidave në rritje në rajon e më gjerë.



FA-të në ndihmë të komunitetit, përfundon ura “Bailey” në fshatin Lapardha 2, Berat

FARSH-të vazhdojnë të ofrojnë mbështetje për zhvillimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, përmes ndihmës direkte në komunitet. Një tjetër urë “Bailey” është dorëzuar së fundmi, si një investim i rëndësishëm për banorët e fshatit Lapardha 2 në Berat.

Specialistët e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios kanë punuar intensivisht për më shumë se dy javë për ndërtimin e urës me gjatësi 27 metër dhe kapacitet mbajtës prej 40 tonë. Ky projekt është një shembull i përkushtimit të Forcave të Armatosura për të ndihmuar dhe përmirësuar infrastrukturën në zonat më të izoluara të vendit. Kjo është ura e dytë “Bailey” që ndërtohet nga Batalioni i Xhenios gjatë vitit 2025.

Gjatë muajve në vijim, Forcat e Armatosura do të vazhdojnë të ndihmojnë me ndërtimin e 10 urave të tjera në zona të ndryshme të vendit, duke dëshmuar dhe konfirmuar vazhdimësinë e kontributit të madh të FA-së në mbështetje të zhvillimit të komuniteteve.

Përfundoi me sukses stërvitja dimërore “Mburoja Albane 33-25” në Voskopojë, Korçë

Trupat e Batalionit III të Këmbësorisë së Jugut të Forcës Tokësore, zhvilluan në rajonin e Voskopojës në Korçë, stërvitjen dimërore 72-orëshe “Mburoja Albane 33-25”.

Qëllimi i kësaj stërvitje ishte dislokimi i trupave të Batalionit III të Këmbësorisë nga rajoni i përhershëm në rajonin e përkohshëm, ngritjen e fushimit, kryerjen e veprimeve mbrojtëse dhe ridislokimin e trupave në bazën e tyre të përhershme.

Përkushtimi dhe profesionalizmi i efektivëve tanë ishin garantues të suksesit të kësaj stërvitjeje, duke dëshmuar gatishmërinë e Forcave Tokësore si pjesë përbërëse e Forcave tona të Armatosura.



U zhvillua Maratona Ndërkombëtare e Bergamos në Itali, ku Forcat e Armatosura të Shqipërisë shkëlqyen falë nënkolonel Bledar Mesit!

Si pjesëtar i ekipit kombëtar të Atletikës dhe Forcave të Armatosura, nënkolonel Mesi garoi në distancën 10 km, duke triumfuar në vendin e parë në kategorinë 35+ mes 1,250 pjesëmarrësve. Ai arriti një rezultat të jashtëzakonshëm prej vetëm 33 minutash! Tashmë pjesëmarrja e nënkolonel Mesit nuk na surprizon më, sepse fitorja në këto kompeticione është pa diskutim e tij dhe flamurit kuq e zi,





Ministri Vengu priti delegacionin e DGA për Evropën Qendrore, Lindore dhe Amerikën Latine

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu dhe delegacioni që e shoqëronte, zhvilluan një takim me drejtorin e DGA për Evropën Qendrore, Lindore dhe Amerikën Latine, gjeneral brigade Emeric Winger, në Ministrinë e Mbrojtjes së Francës. Në fokus të këtij takimi ishte bashkëpunimi i mundshëm në Industrinë e Mbrojtjes. Dy delegacionet diskutuan rreth mundësive për të ofruar ekspertizë dhe praktikë më të mira mbi proceset e zhvillimit të kapaciteteve.

Ministri i Mbrojtjes z. Vengu shprehu interesin e palës shqiptare në lidhje me bashkëpunimin e mundshëm dhe një partneritet afatgjatë me kompanitë franceze të Mbrojtjes, i cili do mund të kontribuojë në prodhimin e brendshëm të Industrisë së Mbrojtjes.

Gjithashtu, në këtë takim u ndanë mendime mbi prioritetet tona, bazuar në Planin Afatgjatë të Zhvillimit të FA 2024-2033. Në kuadër të kësaj marrëdhënie, një ekip shqiptar pritet të udhëtojë në Francë për të zhvilluar një vizitë njohëse mbi pajisjet dhe sistemet e mbrojtjes në përdorim nga forcat franceze.

SHSHPFA uron 33 - vjetorin e krijimit të Policisë Ushtarake

Me rastin e 33 - vjetorit të krijimit të Policisë Ushtarake, kam nderin dhe kënaqësinë t'ju përcjell urimet më të përzemërta!

Gjatë këtyre tri dekadave e më shumë, ju keni treguar gjithmonë profesionalizëm, përkushtim dhe gatishmëri në përmbushjen e misionit të Policisë Ushtarake. Ju keni qenë dhe vazhdoni të jeni garantues të rendit, sigurisë dhe disiplinës ushtarake, duke u bërë një shtyllë thelbësore për funksionimin dhe besueshmërinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Përveç detyrave të përditshme brenda strukturave tona, keni demonstruar aftësi të shkëlqyera në bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë, duke kontribuar në operacione, trajnime dhe misione që kanë rritur imazhin dhe reputacionin e Forcave tona në arenën ndërkombëtare.

Përkushtimi juaj në garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së institucioneve ushtarake, si dhe mbështetja që u ofroni efektivëve në terren, është një vlerë e çmuar për Forcat tona të Armatosura.

Me sfidat e reja që sjellin zhvillimet e kohës, jam i bindur se Policia Ushtarake do të vijojë të modernizohet dhe të përshtatet për të përmbushur me sukses çdo detyrë të ngarkuar, duke qenë një model rregull dhe disipline.



Ministri Pirro Vengu: 500 trupa shqiptare në misionet jashtë vendit Shqipëria linjëzohet 100% me politikën e jashtme të sigurisë së BE-së

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, vazhdojnë të kontribuojnë denjësisht përkrah aleatëve tanë strategjikë në misionet ndërkombëtare, duke rritur me plot 30 trupa praninë e tyre në operacionin e Bashkimit Evropian, ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë. Një togë nga Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë i Forcës Tokësore do të jetë kontingjenti i parë në këtë operacion, ku vitet e fundit FA-të kanë kontribuar me oficerë shtabi.

Në ceremoninë e përcjelljes së këtij kontingjenti nga garnizoni i Zall-Herrit, ishin të pranishëm: ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Igli Hasani, ambasadori i Turqisë në vendin tonë Tayyar Kağan Atay, i Ngarkuari me Punë i BE-së Andre Rizzo, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia etj.

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi se FA-të kanë rritur ndjeshëm pjesëmarrjen në misionet dhe operacionet ndërkombëtare, duke u rreshtuar me politikën e BE-së në kuadër të anëtarësimit në Union. Forcat e Armatosura arrijnë shifrën e 500 efektivëve të dislokuar në mënyrë permanente në misione jashtë vendit. Gra dhe burra, janë të angazhuar çdo ditë, në mbarë Evropën, në Afrikë dhe në Lindjen e Mesme. Përmes këtij kontributi, Shqipëria, jo vetëm dëshmon se linjëzohet 100% me politikën e jashtme të sigurisë së BE-së, por ky është një linjëzim me vepra. Dhe kur e shikojmë se disa prej vendeve të BE-së janë tërhequr nga ky mision, ndërkohë që Shqipëria po merr përgjegjësi shtesë, e kuptojmë edhe më mirë se stabiliteti dhe paqja në rajonin tonë të munduar, është fryt i kompromiseve të vështira.

Më tej, ministri i Mbrojtjes shprehu falënderimet për qeverinë dhe Forcat e Armatosura turke, nën komandën e të cilave do të shërbejë edhe kontingjenti ynë: "Shpreh mirënjohjen time të thellë për sa i përket të gjithë angazhimit dhe mbështetjes që Republika e Turqisë dhe Forcat e Armatosura turke na ofrojnë në këto misione të përbashkëta dhe kjo është një dukuri e parë në fakt që të gjithë aleatët e njohin dhe ia njohin Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura, aftësinë tonë që të ndërveprojmë në misione stabiliteti dhe paqeruajtëse me forcat aleate. Ju do të ndërveproni në kuadër të kompanisë të Forcave të Armatosura turke, e cila ofron të gjithë mbështetjen logjistike", - iu



drejtuara trupave të rreshtuara ministri, i cili nuk nguroi të shprehë krenarinë dhe respektin për punën dhe përkushtimin e ushtarakëve tanë, brenda dhe jashtë vendit.

Nga ana e tij, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Igli Hasani e konsideroi angazhimin e

trupave tona në operacionin ALTHEA më tepër sesa një detyrë ushtarake:

"Ky angazhim nuk është thjesht një detyrë ushtarake, por një dëshmi e qartë e përkushtimit tonë të palëkundur ndaj sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe ndërkombëtar. Pjesëmarrja jonë

në këtë mision pasqyron vlerat që ne ndajmë me partnerët tanë; paqen, bashkëpunimin dhe sigurinë kolektive."

Ambasadori turk Atay theksoi bashkëpunimin e hershëm mes forcave të armatosura të të dy vendeve, të cilat kanë shërbyer krah njëra - tjetrës në Afganistan, megjithatë e konsideroi nisjen e këtij operacioni të ri si një moment të rëndësishëm në vazhdimësinë e bashkëpunimit dypalësh.

I Ngarkuari me Punë i Bashkimit Evropian Andre Rizzo vlerësoi rreshtimin e plotë të Shqipërisë me politikën e jashtme dhe atë të sigurisë së BE-së, duke e konsideruar vendin tonë si një partner të rëndësishëm si mjedisin e sigurisë globale.

Kontingjenti i parë shqiptar në operacionin ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë përbëhet nga 30 trupa, mes të cilave një vajzë dhe do të shërbejë për rreth 6 muaj në Camp Butmir në Sarajevë.

‘Tragjedia e Fekenit’, dëshmi e sakrificës sublime

Tragjedia e stërvitjes dimërore e 6 shkurtit 1981 ishte një ngjarje e shkruar në memorien e gjithë ushtarakëve shqiptarë, por edhe më gjerë. Ishin tre oficerë dhe tetë studentë të ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, që në kujtesën shqiptare quhen “11 dëshmorët e Meçekut”. Stërvitja dimërore masive e trupës studentore dhe pedagogjike në një ditë tepër të vështirë u kthye në një ditë që në memorien ushtarake shqiptare dhe më gjerë është quajtur “Tragjedia e Fekenit”, rrëzë malit të Meçekut. Tashmë janë të rrallë ushtarakët që e kanë jetuar ditën e tragjedisë së ushtarakëve të ish-SHLBO dhe që militojnë në FASH. Megjithatë kujtesa e shqiptarëve nuk mund të harrojë ushtarakët, studentë e pedagogë me në krye komandantin e shkollës Rustem Peçi, shefin e degës mësimore Hysen Shehu e shumë të tjerë, personalitete të shquar ushtarakë, një simbolikë solidariteti ushtarak e njerëzor. Katër dekada e gjysmë kanë shkuar dhe Lapidarët e Fekenit si maja malesh lartësohen në të katër anët e Shqipërisë. Që të gjithë ranë në emër të një kauze të madhe në zemër të malit të Meçekut mbrapa malit të Dajtit në Tiranë. Kjo është dokumentuar në kujtesën e mijëra pjesëmarrësve në stërvitje dimërore, studentë e oficerë, por edhe atyre që me zemër e shpirt ishin në stërvitjen dimërore të studentëve ushtarakë. Një korpus ushtarakësh në unitet vlerash njerëzore. Kështu është regjistruar tashmë jo vetëm në kujtesën e ushtarakëve ngjarja e rëndë tragjike, ku humbën jetën 11 pedagogë e studentë ushtarakë, gjatë një stërvitjeje dimërore në malin me borë përtej Dajtit.

Kështu do t’i sjellin ata me kujtimet e tyre për të mos u harruar kurrë kolegët shokët dhe miqtë e tyre, të cilët mbeten përjetësisht yje të pashuar.

Orteku u mori shokët por jo kujtimin për ‘ta’

Shpend Topallaj kujton: “...Aty nga fundi i gushtit 1960, kisha ardhur nga Tirana, këtu në Durrës, për të takuar prindërit që ishin me pushime dhe të shfaqja edhe njëherë pakënaqësinë time, ngaqë të nesërmen duhej të filloja mësimet në shkollën e mesme ushtarake ‘Skënderbej’, ndërkohë që më qe mbushur mendja për të vazhduar liceun për pikturë, për të cilin kisha prirje. Për një fëmijë trembëdhjetë vjeçar kjo qe më se normale, por prindërit, dëshira ime i kish vënë në siklet. Kur dolën të më përcillnin tek stacioni i Plepave, kur asokohe ndalonte treni, mes turmës që priste, na zuri syri tre skënderbegas të vegjël. Ju afruam dhe pasi babai u tha se ishte oficer, i pyeti për emrat dhe nga ishin. Ai më i shkurtri tha se e qanin Çlirim dhe qe i biri i oficerit Halil Pulaj. Babai i gëzuar, ngaqë kolonel Halilin e kish shok e koleg pune u tregoi rastin tim që e kisha me pishmanllëk shkollën e tyre. Përsëri u hodh Çlirimi i cili serioz si një i madh, tha se kjo shkollë është më e mira në Shqipëri, se ajo vërtetë përgatit kuadrot e ardhshme për ushtrinë, por aty përkrahen e inkurajohen të gjithë ata që duan artin e letërsisë. Në vazhdim ai numëroi disa poetë, shkrimtarë e artistë që kishin dalë nga bankat e shkollës ‘Skënderbej’. Për të gjitha këto përfundoi Çlirimi, ti do të bindesh vetë, ashtu siç do të bindesh se më i bukuri nga të gjithë artet, është ai i mbrojtjes së Atdheut. Premtoi se do të më priste të nesërmen në postbllok dhe u ndamë. Çlirimi ish nga ata që e mbante fjalën: qe i pari njeri që më priti e më përqafoi tek dera e shkollës, pra tek gjersa e ushtrisë ku do të kaloja vitet më të mrekullueshme të jetës sime. Limua ishte një vit para meje, për mua më çudiste autoriteti e respekti që ai gëzonte tek shokët e eprorët. Duke parë pavendosmërinë time, ai jo vetëm që më mbante përherë pranë, por dhe u lutej oficerëve, të cilët përherë e dëgjonin, që të më lejonin të shkoja në shtëpi që të mos mërzhitesha.

Dhe meqenëse kishin të njëjtin trup, gjersa na qepën tonat, më jepte për të veshur uniformën e tij të lirlidaljes. Në njëfarë kuptimi, ai qysh atëherë, u bë me këshillat e tij, jo vetëm shok, por dhe edukatori im. Ashtu si Çlirimi unë njoha shumë shokë të mirë: midis tyre dhe shokun e klasës Nikolla Beron. Ky djalë i thjeshtë Berati, gjithmonë i qeshur e i përzemërt, me urtësinë, thjeshtësinë e sinqeritetin e tij, që nxehej veç kur ish fjala për të mbrojtur të vërtetën, kish fituar dashurinë e tërë shokëve. Nikollaqi ish i gatshëm të ndihmonte këdo, pa u mburrur kurrë për këtë, ndaj dhe kudo ku ka shërbyer, nuk e heqin nga goja, se kudo që shkeli këmba e njeriut të mirë edhe gjurma e tillë mbetet. Me zemër të madhe qe edhe komandanti i batalionit, Dushan Shamenti, oficeri që kish zgjedhur për lajtmotiv, vargjet e heroit të popullit Ali Demi: “Më jep fuqi që të qëndroj/Më

jep guxim që të luftoj/ Më çon në sulm me vrap të shkoj/ Me nder të vdes me nder të rroj”, dhe që i zbatoi ato pa hezitim, gjersa dha frymën e fundit”.

Po çfarë ndodhi atë 6 shkurt të vitit 1981?

Kronologjia e kësaj ngjarje tani thuhet se njihet nga të gjithë. Shkolla e oficerëve kish dalë në fushimin dimëror. Ai që nuk ka qenë ndonjëherë në ato vende, pra ai që malin impozant të Dajtit, e sheh si një dekor piktoresk e tërheqës në sfondin e kryeqytetit, as që mund ta përfytyrojë se ç’ashpërsi, ç’i ftohtë e ç’thyerje e konfiguracionit të terrenit të pret atje. Pas butësisë së Dajtit, fshihet një botë tjetër; aty nis shtrirja e pafund e kodrave e maleve që palë - palë shkojnë drejt veriut. Po të mendosh se vetëm mali i Meçekut arrin kuotën mbi 1827m, e kupton se s’ka asnjë ndryshim nga Korabi e Jezerca. E ja këtë mal me pjerrësi herë - herë 75°, ndërsa frynte një erë e marrë me shpejtësi 40m në sekondë, kish zgjedhur për të ngjitur nënreparti që udhëhiqej nga pedagogu Mark Mici. Në pamje të parë sikur nuk ta mbushte syrin ky burrë i hequr, biond, me sy bojë qielli, me mjekrën pak të dalë që gjithmonë bënte shaka, nga të cilat qeshte edhe vetë me gjithë shpirt. Por po ta njihje nga afër do të mahniste me forcën, vullnetin, rezistencën, shkathtësinë e optimizmin e tij. Ai pa u lodhur i printe kolonës gjersa mbërritën në lartësinë 1400m. Papritur një heshtje kërcënuese, e cila sikur paralajmëronte diçka të keqe pllakosi anë e mbanë. Nuk vonoi shumë dhe një masiv i madh dëbore me zhurmë filloi të rrëshqasë poshtë. Marku e dinte, se pamje të tilla ishin interesante po t’i shikoje në televizor, se në të vërtetë ajo paraqiste një rrezik të madh për jetën e atyre që s’kishin ku të futeshin. Pa humbur kohë ai thirri: “Orteku-mbrohuni!” Po ku të mbroheshin. Sa hap e mbyll sytë, llava i përfshiu të gjithë. Vetëtimthi pyetën veten: Ç’po ngjiste kështu me ta? Një natë më parë qeshën e kënduan gjer në mes të natës. Sot që bora kishte mbërritur gjer në brez, ngjiteshin përpjetë me shkathtësinë e ketrit. Kishin shpirt poeti, ndaj i gëzoheshin bardhësisë verbuese të dëborës.

Dikush nën zë edhe recitonte: “Dëborë bie në pyllin plak”, apo: “Ç’u zunë rrugët me dëborë/ Pranë teje s’mund të vij/ Rri dritareve me orë/Në mendime futur rri”.

...Qenë të rinj dhe dikush mendonte për të dashurën, e dikush kish të drejtë të ëndërronte. Por s’qe e thënë: bora paska si çdo gjë

dhe anën tjetër të saj, atë të tmerrshme, atë të papërballueshme, atë vrastaren që mbuloi gjithçka... Kur çdo gjë kaloi, i pari që u çua qe pedagogu. Ku jeni vëllezër? Dhe me vrull nisi të kërkojë. Pa pushim. Me ngulç. Me dhembje. Dhe sapo i zbulonte, i udhëzonte të kërkonin të tjerët. Pastaj gjeti automatikun dhe zbrazti një krehër të tërë. Kudo u dha alarmi: “Shokët janë në rrezik”. U dëgjuan urdhra e komanda të prera. Por dhe pa ato, ata do të ngjiteshin përpjetë malit, pa ndalur asnjë çast, mjaft të fitonin edhe një sekondë të vetme. Dashuria për shokët u jepte forcë. Në krye udhëhiqnin oficerët, Çlirimi, Dushani, Nikollaqi, Petrit Murzaku, Abaz Çipini, Sali Zhakupi, Muzafer Kambo. U ngrit nga shtrati ku dergjej i sëmurë edhe studenti Nexhip Çopa nga fshati Seferaj. Filloi lufta për jetën. Luftonte vëllai për të shpëtuar vëllain, thuhet se qenë ngjallur vëllezërit Dioskurë, Poluksi dhe Kastori, të njohur për trimërinë që treguan në fushatën e argonautëve, kur anijen e tyre e zuri stuhia.

Dëshmitarët tregojnë:

Kur zbuluan studentin Besnik Shehu, Çlirimi ia mori kokën dhe ia mbështeti me dashuri në gjoks. Kujton se ishte gjallë dhe donte ta ngrohte me zjarrin e zemrës së tij. Ai as që mund ta merrte me mend se ç’dë të ndodhte pas pak me vetë atë. Aty ku mbi kanosjen e pengesat e dëborës, triumfante dëshira për të shpëtuar shokun e cila ndërthurej si rrallë herë me trimërinë e mospasjes frikë nga vdekja, shquhej si një luan i vërtetë, sportisti universal, rezultativi i papërsëritshëm, legjendari dhe i urti Petrit Murzaku, i cili u jepte frymë nga fryma e tij, studentëve, tamam si të qenë bijtë e tij. Një varg me studentë e kuadro ngjitej e vargu tjetër zbriste me shokët e plagosur në krah derisa panë se mungonte vetëm njëri, Aleko Gjonit. O burra, përsëri, të gjejmë e shpëtojmë shokun. Por ...paskej qenë ditë e mallkuar: një ortek i dytë, një masiv i tmerrshëm dëbore, prej mijëra metra kub, filloi të lëvizte me furi drejt studentëve dhe oficerëve si për t’u hakmarrë për mposhtjen e ortekut të parë. Dhe ashtu me ulërimë dhe zhurmë që vinte nga thyerja e pemëve, dëbora mbuloi gjithçka, siç mori me vete rrëshqanthi këdo që gjeti aty, pa pyetur as për herkuljanin Petja, të cilin pasi e zhvendosi nëpër shkrepë rreth 350m, i mbetën jashtë vetëm gishtat. Po të tjerët ku ishin? Nisi puna nga e para me vrull të paepur. Me shumë mund shokët gjendeshin, por tani të gjakosur, me plagë, pa ndenja dhe



Përkujtohet 44 - vjetori i rënies së Dëshmorëve të Fekenit

Në kuadër të 44 - vjetorit të Dëshmorëve të rënë në stërvitjen e Fekenit, pranë Obeliskut të garnizonit “Skënderbej”, u zhvillua një ceremoni përkujtimore.

Në këtë event, ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i AFA-së, kolonel Altin Gjetaj, personeli akademik, studentë të AFA-së, si dhe familjarë e kolegë të dëshmorëve.

Në emër të komandantit të Akademisë, fjalën përshëndetëse e mbajti kolonel Altin Gjetaj. Në Obeliskun e Dëshmorëve të Fekenit u vunë kurora me lule, si dhe u bënë nderime e homazhe nga të afërmit e familjarët e të rënëve.



o zot! Sa shumë të vdekur.

Vladimir Duro tregon: Komandant Dushanin e gjetëm rrëzë një peme. Nga e çara e thellë e ballit i rridhte gjaku që i kish mbuluar fytyrën. Mundohej të ngrihej në këmbë. I vura kokën në gjoks dhe i thirra i mallëngjyer: “Komandant Dushani! Komandant Dushani! Më rrodhën lot për komandantin tonë aq të dashur, me të cilin një natë më parë, gati gjithë reparti ynë kishim qeshur aq shumë deri natën vonë, si nuk shkriu në atë çast dëbora që kisha nën këmbë”. Në krah të tij Nikollaqi, pranë e pranë, thuajse i kish zënë gjumi, pas një lodhje të gjatë. S’të besohej se s’do të ngriheshin kurrë më. Pak më tej të mbajtur për dore qenë shtrirë djali nga Seferaj, trimi Nexhip Çopa dhe shoku i tij Pëllumb Rrapo që i plagosur nga orteku i parë, po transportohej drejt qytzës ushtarake. Mes atyre që e mbanin në sup, mes atyre që shpejtonin të shpëtonin shokun qe dhe Nexhipi. Por orteku që pasoi nuk i kurseu të dy. Siç nuk kish kursyer dhe të mrekullueshmin Çlirim Pulaj, zëri i të cilit ende dukej se jehonte nga njëri shpat në tjetrin: “Forca shokë, kërkoni me guxim”. Kish mbyllur sytë përgjithmonë skënderbegasi simpatik, që pata takuar dikur në stacionin e trenit, i cili edhe pse i vogël në moshë, arriti të më bindë me pjekurinë e durimin e një të rrituri që t’i hyja karrierës ushtarake, pasi ajo, kur punoje me nder, të bënte të respektuar sikur të ishte gjallë, ashtu edhe pas vdekjes. Xha Halil, si nuk t’u ça zemra, ty që t’u vranë shokët ndër duar gjatë luftës, kur dëgjove mandatën. Sa duron njeriu i shkretë, sa e fortë qenka zemra e prindit. Ç’bëre moj dëborë e mallkuar kështu! Si nuk t’u dhimbs shoku besnik Bujar Ago, si nuk të erdhi keq për Ilirin e sinqertë, për Qemal Likën e urtë, që pak para se të vdiste u ndau shokëve karamelet që kishte në xhep, sikur po martohej dhe jo po shkonte për të mos u kthyer kurrë më, për Pëllumbin që shkruante vjersha plot ndjenjë e që ndofta atë ditë do të shkruante edhe për dëborën që i doli tradhtare dhe e pabesë, si e preve moj dëborë në mes këngën e Besnik Shehut, jetën e Bilbil Pashait që e donte aq shumë dhe të Alekos që e donin aq shumë... Në këtë përleshje të pabarabartë, më çmenduritë e natyrës. ku morën pjesë 203 vetë, shumica e të cilëve qe farkëtuar në shkollën “Skënderbej”, bilanci përfundimtar qe tepër tragjik. E parë me syrin e një ushtaraku me përvojë, është e kuptueshme se po të mungonte shpirti i pamposhtur luftarak dëmi do të qe i pallogaritshëm.

...Këtu ngjet si në luftë, ku gjen zbatim sentenca e famshme se “Në tërheqje me panik, vdesin më tepër ushtarë se në betejë”. Nga ana tjetër, ndofta pikërisht për shkak të kësaj beteje, ne jemi mbledhur për t’i kujtuar me veneration vëllezërit tanë dëshmorë, duke evokuar me këtë rast maksimën e Ovidit se “Kush do ta njihje Hektorin po të mos ndodhte fatkeqësia e Trojës?”

VIKTIMAT E TRAGJEDISË SË FEKENIT:

- Komandant Dushan Shametaj
- Shef i Planëzimit Çlirim Pulaj
- Pedagog Nikollaq Bero
- Student Bilbil Pashaj
- Student Aleko Gjoni
- Student Qemal Lika
- Student Besnik Shehu
- Student Pellumb Rrapo
- Student Ilir Gramatiko
- Student Nexhip Copa
- Student Bujar Ago

BALLADA E TË NJËMBËDHJETËVE (Kujtimit të dëshmorëve skënderbegas që u vranë nga orteku)

Agim Bajrami

*Kli th` një er` e ftohtë
Në rrëz` të Meçekut
Sikur do t`i zgjojë
Shokët posht` ortekut.*

*Netëve të gjata
Nën një hën` që qan
Njëmbëdhjet` balada
Shtrirë pran` e pran`.*

*Njëmbëdhjet` ballada
Gatuar me djej
Me zjarre nga vatra
Shkolla “Skënderbej”.*

*Ku u nisët bij
Atë dit` mortore
Qie lli t ngjyrë gri
Me sy prej dëbore.*

*Flokshprishur nga era
Pabesi e shtegut
Me këmb` mbi humnera
Dhe grack` e ortekut.*

*Nën vështrim të malit
Mbështjellë prej murlanit
Se nuk din` të ndalen
Bijt’ e partizanit.*

*Ballet mbushur yje
Poezi rinie
Dimri nëpër pyje
Shfryn mll ef xhelozie.*

*Shfryn mll ef xhelozie
Ndaj dhe ngrihka leqe
Ah ju bij lirie
Ç`ju zu or` e keqe.*

*Në mal të Meçekut
Ç`tmerr ju panë sytë
Nën klithm` të ortekut
Sulmuan stuhitë.*

*Sulmuan stuhitë
Me khetra mizore
Feken si s`t`u dhimbs
Nikua që na more.*

*Kur rrëmbeve Limon
Si se pyete zemrën
Mbi gjoks bashk` me yllin
Kish një vjersh` për nënën.*

Po Qemalin bir

*Me vështrim si dele
Sa kish ndar` për shokët
Një grusht karamele.*

*Karamele morti
Të verdha si fua
Në mosh` të mëngjesit
I dhe vdekjen grua.*

*Krisma ngre kushtrimin
Gjaku skuq mbi tokë
Dyqind kryetrima
Për njëmbëdhjetë shokë.*

*Jeta sfidon vdekjen
Me sy dashurie
Sa zbulojn` Alekon
Një shok` tjetër bie.*

*Na iku Bujari
Me shpirt prej poeti
Në sup të Bilbilit
Çast` i mbam` e gjeti.*

*Komandant Dushani
Lis me tre kurora
Nuk i dilka xhani
Pa zënë bijt` nga dora.*

*Si t`i mbroj nga vdekja
Nga bora me gurë
E çfarë bën` më tepër
Vëllezërit Dioskurë?*

*Nën këng` elegjie
Prehet monopatii
Trimi Nexhip Çopa
Që u ngrit prej shtratit.*

*S`mund të rrinte brënda
E si mund të rrinte?
Kur vdekja tinzare
Shokët radhë i shtrinte.*

*Ilir Gramatiko
Pëllumbi, Besniku
Vdekjen vun` përpara
Pa dridhje qerpiku.*

*Mben` të gjith` atje
Me vështrim nga prita
T`i tregojn` mëngjesit
Shtigjet nga vjen drita.*

*Në mal të Meçekut
Në buz` të humnerës
Njëmbëdhejtë ballada
Frymojn` prej pranverës.*

Për martirët e Fekenit... Myslim Pashaj

Ne ishim dje atje, tek rrënjët e Shkollës Skënderbej. Përvjetori i shtatëdhjetë. Hodha sytë rrotull. Thirra. Vrojtova. Nuk po i dalloja sytë e tyre, sytë e Bilbilit dhe Çlirimit. Njëri: vëlla dhe tjetri shok i bankës, i hartës e i koordinatës. Kisha atë çrregullimin tronditës që ta jep koha dhe hapësira, në bashkësinë rrotull, në raste të tilla. Pastaj ata u dukën dikund, mbi perden e rëndë të harresës, në të njëjtën kinema, ku dikur shfaqeshin filma të revolucionit, me të cilët ishin rritur të dy. Ngjanin të mërzitur dhe gati të mos më flisnin. I ranë tërthor sallës, dhe nuk po njihnin moshën, që ishte thinjur, ndërkaq ata vinin nga një kohë tjetër, e ata nuk kishin dashur kurrë të thinjeshin e të plakeshin, ata donin të mbeteshin të rinj, ashtu duke u ngjitur. Pastaj erdhën dhe u mbështeten në murin anësor, sepse nuk kish vende se ku të uleshin, Çlirimi në krahë të Kiço Mustaqit dhe Bilbili në krahun tim. Ne filluam të flisnim fjalë të thyera, se befasia na kapi në çast. Mirëpo të dy, si në të njëjtën gojë bënë shenjë të mos ndiheshim, sepse ata e kishin ndjekur jo vetëm Ortekun që i mori por edhe ortekun që përfshiu një shoqëri të tërë që vijon ende të jetë e çoroditur. Po dëgjonin edhe ca fjalime nga këta të mbeturit e sotëm. Askush rrotull nuk po i njihte. Shpirti është gjithnjë i ri, edhe pse i vjen edhe atij fundi. Po ama është i ri. Skënderbegasit e kishin lënë shpirtin e tyre diku në përfytyrime ëndrrash. “Më mirë që ikëm të rinj”, - thanë. Pastaj u përthithën nga fryma dhe ne e kuptuam se ata kishin një pjesë nga fryma që bartim ne skënderbegasit, të gjallë. Dikush ma solli lajmin se në çdo përvjetor Vladimir Pulaj, i vëllai i Çlirimit në krahë të një saksie me lule del për të pirë një kafe me Çlirimin.

“Po ti, ku po shkon?”, - më tha Kiço Mustaqi, komandanti ynë i togës.

“Po shkoj në vendlindjen e Bilbilit, atje ku është një gur të cilin ia thonë emrin “Guri i Ullirit të Burimit”

POEZI PËR ÇLIRIM PULAJN
*Ja, nga dritarja që u hap
Del Skënderbegasi përbri.
Çlirimi iku, erdhi prapë,
Po aq i bukur dhe i ri.*

*Në këtë fragment` që sjell orteku
Apo dëbora dhe acari.
Çlirim i Pulajve, tek shtegu
Prapë skënderbegas, si i pari.*

*Në sup, i rëndë, një mal i ngritur
Çlirim, sa gjëra që kanë rrjedhur!
Më mirë që ike pa e ditur,
Se do të rrudheshe patjetër.*

*Tani ti vjen, në festa, mbresa,
Se vet je mbresa më e thellë.
Çlirim i Pulajve, kujtesa
E ka një strehë që rri mbështjellë.*

*Ajo që ne s’e themi dot:
Më mirë në ortek të ishim matur,
Se sa të grindet, jetë e mot,
Nga ankthi që godet i çartur.*

*Po gjersa diellin ti e deshe
Bashkë me Bilbilin *) tim vëlla,
S’menduat kurrë se iku shpresa,
Se ikin ëndrrat e mëdha.*

*Ne bashkë e bëmë dikur një hartë,
Diku mbi malin e Ivanit,
Aty ti rron si koordinatë,
Që nuk ndryshon përmes tufanit.*



PU, repartit elitë në historikun e tij 33-vjeçar

Policia Ushtarake festoi 33-vjetorin e krijimit të saj. Përgjatë 33 viteve të historisë së saj, Policia Ushtarake ka treguar se është një nga repartet elitë të Forcave tona të Armatosura.

Ruajtja e rendit ushtarak, garantimi i zbatimit të ligjit, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e humanitare janë misioni kryesor i kësaj njësie.

Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura u formua, më 1 shkurt 1992.

Pas viteve 90', ashtu si në të gjithë vendin edhe në FA u kryen një sërë reformash. Ndër to: miratimi i akteve ligjore, nënligjore, si dhe ndryshime strukturore, ku pjesë e këtyre ndryshimeve ishte dhe krijimi i PU-së në përbërje të FA-së.

Formimi i kësaj strukture kishte si qëllim forcimin e rregullit dhe të disiplinës në FA dhe u pa si domosdoshmëri për transformimin e ushtrisë sipas standardeve të vendeve të NATO-s.

Me krijimin e PU-së, objekti i punës së saj ishte kontrolli i trafikut ushtarak, ruajtja e rendit ushtarak në FA, me synim forcimin e disiplinës ushtarake në FA.

Në dhjetor të vitit 1994, me urdhër nr. 482, datë 10.12.1994 të MM, "Për organizimin e Policisë Ushtarake", strukturës së PU-së iu bashkëngjit struktura e Policisë Kriminale dhe ajo e Mbrojtjes nga Zjarri. Në fillim të vitit 1995 u transformua në drejtori të PU-së, me drejtor gjeneral brigade Bajram Malaj.

Me mbështetje ligjore, nënligjore si dhe me profesionalizëm gjithnjë në rritje, PU-ja u radhit ndër repartet më të mira të FA-së. Pas ngjarjeve të vitit 1997, drejtori i Drejtorisë së PU-së ishte kolonel Piro Lutaj.

Pas ngjarjeve të vitit 1997, PU pati një rritje të jashtëzakonshme mbi bazën e një projekti me Delegacionin Italian të Ekspertëve (DIE), për herë të parë, me asistencën e specialistëve italianë u krijua batalioni i PU-së në Tiranë, i cili u kompletua me bazën materiale e logjistike të nevojshme dhe u konceptua sipas modelit të batalioneve të karabinierisë italiane. Krijimi i batalionit të PU-së në Tiranë, shënon një hop cilësor në veprimtarinë e kësaj strukture moderne dhe nga më cilësore të kohës, gjë që u duk qartë në ngjarjet e vitit 1998, kur PU jo vetëm që nuk u dëmtua por ajo mori në ruajtje disa nga institucionet kryesore të shtetit si: Radio Televizioni Shqiptar, Telekomin, Prokurorinë e Përgjithshme si

● *Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura u formua, më 1 shkurt 1992. Pas viteve 90', ashtu si në të gjithë vendin edhe në FA u kryen një sërë reformash. Ndër to: miratimi i akteve ligjore, nënligjore, si dhe ndryshime strukturore, ku pjesë e këtyre ndryshimeve ishte dhe krijimi i PU-së në përbërje të FA-së.*

dhe disa institucione ndërkombëtare.

Në këtë periudhë, PU-ja ishte një nga institucionet e pakta moderne që ishte ndërtuar deri në atë kohë dhe që ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm në rivendosjen e shtetit ligjor në Shqipëri.

Kompletimi i batalionit të PU-së në Tiranë, me teknikën e nevojshme dhe automjete të blinduar tip IVECO-90, luajti një rol të jashtëzakonshëm në ngjarjet e vitit 1998 në Shqipëri. I pamohueshëm mbetet roli i kësaj strukture në vitin 1999, në kohën e krizës së Kosovës, ku PU mbajti peshën kryesore në pritjen, shoqërimin, trajtimin e refugjatëve pranë kampingeve të ngritura në Kukës, Tiranë, Durrës dhe qytete të tjera të vendit, mbajtjen nën kontroll të

situatës në zonat Kukës, Krumë, Tropojë, sidomos pranë postave kufitare, duke zgjidhur mjaft situata të vështira, shoqërimin e mjaft autokolonave dhe personaliteteve që lëviznin për në veri dhe kthim, si dhe mbajtjen nën kontroll të rrjetit rrugor në të gjithë vendin e veçanërisht në veri. Ngjarjet e vitit 1997, 1998 dhe ato të krizës kosovare janë ngjarjet më të rëndësishme në historinë e PU-së.

Për kryerjen e këtyre detyrave, PU u mbështet dhe në miratimin e Ligjit nr. 8404, datë 15.09.1998, për një shtesë në Ligjin nr.7978, datë 26.07.1995, "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Në fund të vitit 2000, me suprimimin e strukturës së Drejtorisë



së Policisë Ushtarake, me Urdhër nr.1, datë 05.01.2001të MM, “Për organizimin e regjimentit të Policisë Ushtarake”, u krijua regjimenti i PU-së me komandant nënkolonel Namik Goga. Kjo strukturë e ushtri aktivitetin e saj deri në shtator të vitit 2003, duke bërë ruajtjen dhe sigurimin e të gjitha stërvitjeve që zhvilloheshin në territorin e vendit tonë.

Në shtator të vitit 2003, kjo strukturë u transformua në strukturën e batalionit me qendër në Tiranë, me komandant batalioni nënkolonel Xhevahir Abdia, i cili e ushtri detyrën deri në vitin 2005. Në vitin 2005 komandant batalioni u emërua nënkolonel Drini Nikolla, i cili e ushtri këtë detyrë deri në vitin 2008.

Në korrik të vitit 2007, batalioni i PU-së ishte pjesë organike e Komandës Mbështetëse, me varësi drejtimi administrativ në Komandën Mbështetëse dhe Komandim Operacional nga SHPFA. Në përbërje të këtij batalioni ishin 4 seksione të PU-së në rrethet Shkodër, Durrës, Berat, Vlorë dhe 5 nënseksione të PU-së, në rrethet Kukës, Burrel, Elbasan, Korçë dhe Gjirokastrë,

Në vitin 2008, komandanti i batalionit të PU-së emërohet kolonel Xhevdet Zeneli. Në maj të vitit struktura e Policisë Ushtarake kaloi në Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura, në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9069, datë 15.05.2003, “Për Policinë Ushtarake në FA”. Në qershor të 2012, komandant i PU emërohet kolonel Syrja Gjoka. Në gusht të 2012, komandant i PU emërohet kolonel Ylli Zyla. Në shtator të 2013, komandant i PU emërohet kolonel Xhevdet Zeneli. Veprimtaria e PU-së përcaktohet nga misioni dhe detyrat që parashikohen në ligjin, “Për Policinë Ushtarake në FARSH” dhe “Kodi Penal Ushtarak”. Hartimi dhe miratimi në Kuvend i këtij ligji në vitin 2003, shënon një ristrukturim të plotë të kësaj strukture. Gjatë kësaj periudhe është punuar për kompletimin e PU-së me personel të motivuar, arsimuar në vendet anëtare të NATO-s, si në Turqi, Itali, Gjermani. Realizimi i misionit dhe detyrave funksionale është mbështetur në aktet ligjore e nënligjore.

Gjatë këtyre viteve PU, është trajnuar nga specialist të karabinierisë italiane, policisë ushtarake amerikane, gjermane dhe turke.

Prej vitesh, njësia e PU-së po përgatit me një program të veçantë një nënrepart të nivelit togë NRF (NATO Response Force), si forcë e gatshme për të vepruar në përbërje të strukturës përkatëse të NATO-s, e aftë dhe e pajisur përshtatshmërisht për të përmbushur detyrat. Gjithashtu, PU ka kryer një mision në operacionin ushtarak “ISAF”, në Kabul, Afganistan. Kontingjenti i kësaj toge përbëhej nga një efektiv prej 22 vetash.

Një kontribut të madh, efektivi i PU-së ka dhënë në emergjencat civile, ku kanë treguar gatishmëri dhe profesionalizëm në kryerjen e detyrave të marra.

Tashmë, struktura e PU-së është e përgatitur për të vepruar në të gjithë spektrin e misionit, detyrave, si edhe të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse dhe humanitare.

- Ruajtja e rendit ushtarak në FARSH, zbulimi, parandalimi, ndjekja e veprimtarisë kriminale, angazhimi në luftën kundër terrorizmit, marrja pjesë në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, si dhe mbrojtja e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura nga veprimet e kundërligjshme. Siguron rendin ushtarak jashtë reparteve ushtarake në mjediset publike e jopublike.
- Mbron jetën, shëndetin dhe dinjitetin e ushtarakut nga çdo veprim i paligjshëm kur ato cenohen për shkak të detyrës.
- Mbron pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të FA-së nga veprimtari të kundërligjshme.
- Ndërhyn për të mënjauar aktet e terrorizmit në FA.
- Punon për zbulimin, parandalimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale ndaj pjesëtarëve të FA-së, pronës dhe objekteve ushtarake.

- Zbaton vendimet e gjykatës, aktet e Prokurorisë Ushtarake për kërkimin, kapjen dhe sjelljen forcërisht të ushtarakëve që i fshihen procedimit penal ose i shmangen vuajtjes së dënimit.
- Kontrollon dhe siguron transportin ushtarak.
- Kontrollon lëvizjen dhe shfrytëzimin e mjeteve dhe teknikës ushtarake.
- Kontrollon e merr masa për zbatimin e legjislacionit të Masave të Ndërhyrjes kundra Zjarrit (MNZ).
- Siguron zbatimin e rendit ushtarak gjatë zhvillimit të stërvitjeve, veprimtarisë dhe ceremonive ushtarake të organizuara nga SHPFA.
- Shoqëron e siguron personalitetet e larta ushtarake të FA-së, si dhe delegacionet e huaja të njehsuara me to.
- Kryen detyra në interes të forcave ushtarake shqiptare që kryejnë misione jashtë shtetit, si dhe të forcave të huaja ushtarake që veprojnë në Shqipëri në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Kryen e mbështet operacionet humanitare.





KOLONEL HYSNI GJERGJI

Militarizimi i arsimit civil rus tregon që paqja është larg

Viti shkollor 2024-2025 për shkollat tetëvjeçare dhe të mesme ruse, do të ketë disa ndryshime të tjera të rëndësishme për fëmijët dhe të rinjtë rusë. Me kthimin e trajnimit bazë ushtarak në shkolla duke filluar nga 1 shtatori 2023, militarizimi praktik së shpejti do të shoqërohet me militarizimin teorik. Sergei Mironov, kreu i partisë “Një Rusi e drejtë”, deklaroi se qëllimi kryesor është përgatitja sistematike e qytetarëve për luftë të mundshme. Kjo nismë mori mbështetje të fortë nga Ministria e Mbrojtjes. Kursi do të përfshijë praktikën e qitjeve, trajtimin me granata dore dhe mësimin e bazave të ndihmës së parë në fushën e betejës. Gjatë këtyre mësimëve, rusët me përvojë ushtarake, përfshirë veteranët e luftës në Ukrainë, ndajnë përvojat e tyre personale në klasë.

Në dy vitet e fundit në të gjithë sistemin arsimor rus vihet re organizimi i programeve mësimore dhe të trajnimit të personelit ushtarak dhe civil për të kundërshtuar luftën informative dhe hibride të nisur nga perëndimi kundër Federatës Ruse në lidhje me fillimin e Operacionit Special. Programet e tilla si “Informacioni dhe luftërat hibride” përbëjnë bazën e një sistemi mbarëkombëtar të kundërveprimit ndaj informacionit dhe operacioneve të luftës hibride të Federatës Ruse.

Në qershor 2022, pesë muaj pas nisjes së agresionit, në Universitetin Shtetëror të Moskës MV Lomonosov, u bë hapja e programit master “Informacioni dhe luftërat hibride”. Ky është programi i parë në universitetet ruse që synon trajnimin e studentëve për të luftuar informacionin dhe luftën hibride. Ndërsa universitetet publike dhe private ruse sapo kanë filluar të formojnë kurse speciale të trajnimit dhe programeve arsimore shtesë mbi luftërat hibride, dezinformacionin dhe falsifikimet.

Universiteti Shtetëror i Moskës ka bërë tashmë programin e tij special dhe ka rekrutuar studentët që janë të gatshëm për t’u bashkuar ushtrisë së hakerave rusë. Kështu që Universiteti Shtetëror i Moskës nisi një “Garë të Madhe” patriotike për të fituar në luftën hibride që ishte planifikuar dhe po drejtohej kundër Rusisë. Hapja e programit ishte hapi i parë serioz në formimin e një sistemi të shtetëror për të mbrojtur informacionin dhe luftërat informative, duke siguruar personelin e trajnuar posaçërisht për të ardhmen e luftërave.

I pari nga këto programe ishte programi i masterit “Informacioni dhe Konfliktet Hibride”, i hapur në vitin 2019 në Universitetin Shtetëror të Sevastopolit (Instituti i Shkencave Sociale dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare) me iniciativën e profesorit AV Manoilo, ky program ishte programi i parë master në Federatën Ruse që trajnon specialistë për, luftërat hibride dhe tregtare. Hapja e programit u njoftua zyrtarisht nga RIA Novosti, më 6 qershor 2019, në telekonferencën Moskë-Sevastopol-Tallin-Kisinau “Informacioni dhe luftërat hibride: si të arrihet përparim në fushën e teknologjive humanitare dhe si ti kundërpërgjigjemi kërcënimeve”.

Sipas blogerit kolonel Cassad, “Tema e studimit të informacionit dhe luftërave hibride është krijuar për të prodhuar specialistë, të cilët ose mund të përdoren për të zbatuar detyra komplekse analitike dhe praktike në nivelin shtetëror, ose në punën e mediave më të mëdha federale dhe strukturave të korporatave”. Kjo rezonon edhe me detyrat që, u vendosën në Këshillin e Sigurimit të Federatës Ruse”. Ishte ky program që u bë prototipi i programit të ardhshëm të Informacionit dhe Luftërave Hibride, i cili përfshinte kurse të tilla si “Bazat e teorisë dhe metodologjisë së luftërave hibride”; “Luftërat ekonomike”, “Komponenti diplomatik i luftërave hibride” (përfshirë këtu “veprimtarinë e misionëve diplomatike në kushtet e luftës” dhe “aktivitetet informative të Ministrisë së Punëve të Jashtme si një mjet për të luftuar “Revolucionet me ngjyra”; “Grushtet e shtetit etj. Programe të tjera janë “Përbërësi teknik i luftërave hibride” përfshirë “inteligjencën teknike” dhe “Fuqia e butë në sistemin e instrumenteve të një lufte hibride”.

Të gjitha kurset në 2019-2020 u bënë mbi bazat e ekipit të ardhshëm të instruktorëve dhe pedagogëve të



programit, i hapur në vitin 2022 në Universitetin Shtetëror të Moskës. Kombinimi i përvojës së tyre, duke i shtuar përkushtimin patriotik dhe ideologjik të praktikuesve më të mirë në këtë pikë, synonte efekt kulmor në arsim. Fillimi i suksesshëm i programit u sigurua edhe nga zgjedhja e vendit të zbatimit të tij që është qyteti i Sevastopolit pozicionuar në kufijtë jugorë të Rusisë, i cili supozohet të jetë nën vëzhgimin e ngushtë të shërbimeve të inteligjencës të të gjitha vendeve të “Perëndimit Kolektiv”, si i quajné rusët. Qyteti për zbatimin e programit nuk u zgjodh rastësisht: Krimea, e cila u kthye në portin rus të lindjes, më 2014, vjet më parë, dhe qyteti i Sevastopolit, qyteti-kyç në kufi me Evropën Jugore. Nisja e programit “Informacioni dhe Konfliktet Hibride” ishte përvoja e parë e organizimit të trajnimit të specialistëve për luftën hibride në nivel federativ.

Programi i masterit “Informacioni dhe Luftërat Hibride” ofron trajnime për specialistë në fushën e përballjes me teknologjitë e informacionit modern, luftërat hibride, tregtare dhe revolucionet me ngjyra, të cilët janë në gjendje të vënë në praktikë qasjet moderne konfliktologjike, metodat për analizimin dhe parashikimin e këtyre fenomeneve etj. Qëllimi i programit është të sigurojë trajnime për specialistë të cilët janë në gjendje, si në mënyrë të pavarur ashtu edhe si pjesë e një ekipi, të zhvillojnë, planifikojnë dhe zbatojnë operacione për të kundërshtuar informacionin perëndimor, luftën hibride dhe revolucionet hibride me ngjyra.

Programi përfshin kurset më të mira për praktikuesit me përvojë në shërbimin inteligjent dhe në organe dhe struktura të veçanta. Blloku kryesor i disiplinave, të detyrueshme dhe opsionale, janë disiplinat operacionale, nga operacionet

psikologjike, psikologjia e gjendjeve ekstreme deri te studimi i formave dhe metodave të kundërveprimit kundër informacionit dhe operacioneve hibride të luftës. Programi përfshin zhvillimet më të fundit në fushën e organizimit dhe kryerjes së operacioneve informative, kombinimeve operacionale dhe praktikave operacionale të shërbimeve speciale. Praktika më e fundit e operacioneve të informacionit në marrëdhëniet ruso-amerikane, propaganda speciale dhe luftimi i falsifikimeve në kushtet e operacioneve speciale ushtarake dhe policore janë programet e para pas fillimit të luftës. Hyrje në teorinë dhe metodologjinë e informacionit modern dhe luftërave hibride është një nga programet që universitetet e vendosën në programet e tyre prioritare. Këto disiplina dhe programe zbulojnë forma, metoda, teknologji, teknika dhe truket specifike të përdorura në operacionet moderne të luftës kibernetike të zhvilluara kundër Federatës Ruse.

Këto kurse zhvillohen nga specialistë me përvojë personale në organizimin dhe kryerjen e operacioneve informative jashtë Rusisë si dhe nga fusha e luftërave hibride në zona të tjera sipas situatës. Program shumë interesant ka qenë ai që përfshin një kurs të veçantë me titullin “Veçoritë e organizimit të administratave ushtarako-civile në territoret e çliruara”. Ky është vetëm një kurs praktik që drejtohet nga specialistë në terren dhe është pikërisht ajo që ata po bëjnë atje tani. Ky është kursi i parë që synon përgatitjen e specialistëve për administratat e ardhshme ushtarako-civile në zonat e aneksuara.

Praktika më e fundit e luftimit të grushteve të shtetit hibrid e “revolucioneve me ngjyra”, duke marrë studentë edhe nga shtetet aleate si Kazakistani, Bjellorusia, Bolivia e Venezuela, të cilat kanë përjetuar disa tentativa të organizimit të grushteve të shtetit në periudhën post-sovjetike.

Në kuadër të formimit profesional, shumë vëmendje i kushtohet edhe trajnimit të veçantë patriotik, operativ dhe psikologjisë së punës në kushte ekstreme. Për këtë qëllim, programi përfshin kurse të tilla si “Psikologjia e gjendjeve ekstreme”, “Teknika të tjera të komunikimit efektiv në politikë”, “Sjellja në një turmë agresive2 etj. Këto janë programe të publikuara nga sistemi arsimor rus në periudhën pas 2022, që siç shikohet është kthyer i gjithi në dispozicion të luftës hibride dhe operacioneve informative të dezinformacionit kundër Perëndimit dhe NATO-s. Çfarë programesh kanë përmirësuar dhe përditësuar akademitë ushtarake dhe institucionet e tjera të sigurisë kombëtare, besojmë se përgjigja duhet të jetë logjike si shumëfishi i atyre që ne listuam më lart.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ky është një realitet i hidhur i shoqërisë sonë, ku paragjykimet shpesh krijojnë një mjedis ku padrejtësitë injorohen, ndërsa veprimet e lira dhe konsensuale kritikohen. Ky është një refleksion i hipokrizisë së normave sociale, që shpesh heshtin për dhunën dhe padrejtësinë. Si shoqëri, duhet të punojmë për të ndërtuar një kulturë, ku dhuna dënohet me zë të lartë dhe drejtësia kërkohet pa kompromise, ndërsa dashuria dhe liria e individit respektohen.

Është tragjike që shoqëria shpesh zgjedh të mbyllë sytë ndaj padrejtësive të mëdha, ndërsa merret me moralizime sipërfaqësore për çështje që nuk dëmtojnë askënd. Kur një viktimë e dhunës injorohet ose fajësohet, ndërsa një veprim i lirë dhe i dashur gjykohet publikisht, kjo tregon se diçka është thellësisht e gabuar në sistemin tonë të vlerave. Ndryshimi fillon nga ne, duke folur hapur për këto padrejtësi, duke edukuar veten dhe të tjerët dhe duke sfiduar normat e padrejta.

Shoqëria duhet të ndalojë së fajësuar viktimat dhe të fillojë të mbajë përgjegjësi ata që shkaktojnë dhunë. Vetëm atëherë mund të krijojmë një realitet ku drejtësia dhe liria nuk janë vetëm fjalë boshe. Dhe kjo arrihet duke ndërtuar një kulturë më të drejtë, e cila kërkon ndryshime të thella në mentalitet, edukim dhe sistemin ligjor. Siç janë, edukimi qysh nga fëmijëria ku puna e prindërve është t’u mësojnë atyre për barazinë gjinore, respektin dhe kufijtë personalë.

Ndërgjegjësimi në shkolla dhe media. Duhet të ketë më shumë programe edukative që sfidojnë normat patriarkale dhe promovojnë drejtësinë sociale.

Zbatim i ligjeve të rrepta kundër dhunës dhe abuzimit, tolerancë zero për dhunën seksuale, psikologjike apo fizike. Shoqëria duhet të ndalojë së fajësuar viktimat dhe të ndalojë gjykimet hipokrite mbi sjelljet e njerëzve, veçanërisht të grave. Gratë duhet të kenë të njëjtën liri për të jetuar pa frikë dhe pa gjykim.

Të mos heshtim kur shohim diçka të gabuar. Solidariteti dhe mbështetja për viktimat janë të domosdoshme.

Secili mund të jetë një shembull, duke trajtuar të tjerët me respekt dhe duke sfiduar normat e padrejta. Një shoqëri e drejtë nuk ndërtohet brenda natës, por çdo hap drejt barazisë dhe drejtësisë ka vlerë.

Një vajzë nuk duhet të gjykohet për zgjedhjet e saj, ndërsa një djalë lavdërohet për të njëjtën gjë.

Nëse nuk ndryshojmë mënyrën se si njerëzit mendojnë, edhe ligjet më të mira do të mbeten thjesht letra. Por, nëse vetëm ndryshojmë mendësinë dhe nuk kemi mekanizma ligjorë dhe institucionalë për të mbrojtur të drejtat, ndryshimi nuk do të ndodhë kurrë. Prandaj, duhet një qasje e plotë që përfshin edukimin, ligjet, median dhe përgjegjësinë sociale.


Vajzat shpesh përballen me një realitet, ku liria e tyre është e kufizuar nga normat sociale. Vajzat shpesh ndihen të kufizuara në veshje, dalje dhe mënyrën se si sillen në publik.

Nëse një vajzë del vonë natën, ajo mund të gjykohet dhe të quhet “e pamoralshme”, ndërsa për një djalë kjo shihet si normale.

Presioni për të qenë “e ndershme”

Nderi i një familjeje shpesh lidhet me sjelljen e vajzës, duke e bërë atë përgjegjëse për imazhin familjar. Vajzat shpesh trajtohen ndryshe kur bëhet fjalë për marrëdhëniet dhe seksualitetin, ndërsa djemtë inkurajohen të jenë “të lirë”. Shumë vajza ende rriten me idenë se duhet të jenë të bindura, të kujdesen për shtëpinë dhe familjen, ndërsa djemtë inkurajohen të jenë ambiciozë dhe të ndjekin karrierën. Një

“Një vajzë u përdhunua në mes të ditës, nuk e pa askush. Një vajzë puthi një djalë në errësirën e natës dhe... e panë të gjithë”



grua e suksesshme shpesh përballlet me komente si “Po kur do martohesh?”, apo “Karriera nuk është gjithçka për një grua”. Nëse një vajzë përballlet me dhunë apo ngacmim, shpesh dëgjon fraza si: “Po çfarë kishe veshur?”, “Pse ishe vetëm?”, duke e bërë atë të ndjejë faj, në vend që shoqëria të mbajë përgjegjësi autorin e dhunës.

Fatkeqësisht kjo është një nga frazat më të padrejta dhe toksike që përdoret ende në realitetin shqiptar, kur një vajzë përballlet me ngacmim apo dhunë. Në vend që të mbahet përgjegjës personi që kryen dhunën, shoqëria shpesh e fajëson vajzën, duke e bërë atë të ndihet sikur është vetë shkaktoresh e asaj që i ka ndodhur. Ky mentalitet është një nga arsyt pse shumë viktimat nuk guxojnë të flasin apo të kërkojnë drejtësi.

Fajësimi i viktimës justifikon dhunën – Nëse një djalë sillet keq, nuk është sepse “vajza e provokoi”, por sepse ai nuk respekton kufijtë dhe nuk merr përgjegjësi për veprimet e tij.

Liria e vajzës nuk është ftesë për abuzim

Pavarësisht se si vishet një vajzë, ku ndodhet apo me kë flet, askush nuk ka të drejtë ta prekë apo ta ngacmojë pa dëshirën e saj. Kultura e fajësimit bën që shumë raste të mos raportohen, shumë vajza nuk kërkojnë ndihmë, sepse kanë frikë se do të gjykojnë në vend që të mbrohen. Shoqëria duhet të mbajë përgjegjësi autorët e dhunës, jo viktimat.

Familjet dhe shkollat duhet të edukojnë djemtë për respektin dhe barazinë...

Vajzat duhet të mbështeten, jo të gjykojnë. Nuk ka “ajo e provokoi”, ka ai nuk e respektoi! Mentaliteti i fajësimit të viktimës është një problem serioz që duhet të ndryshohet nga rrënjët. Nuk ka justifikim për ngacmimin apo dhunën, problemi nuk është tek vajza, por tek ai që nuk e respekton kufirin dhe dinjitetin e tjetrit.

Asnjë veshje, sjellje apo fjalë nuk është “ftesë” për dhunë apo ngacmim. Djemtë duhet të mësojnë të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre dhe të mos kërkojnë justifikime si “ajo më

provokoi”.

Nuk mjafton që Shqipëria të ketë ligje kundër dhunës dhe ngacmimit, ato duhet të zbatohen pa kompromis! Denoncimet nga vajzat duhet të trajtohen seriozisht, jo të injorohen apo të përqeshen.

Ngacmimi seksual në rrugë, në shkolla apo në vendin e punës duhet të ndëshkohet realisht. Policia dhe gjykatat duhet të ndalojnë mentalitetin e “po ç’bëri ajo që ndodhi kjo?”.

Mediat shqiptare shpesh fajësojnë vajzat, duke përdorur tituj si: “Ajo e kërkoi vetë”, “Ishte e veshur në mënyrë provokuese”, “Doli natën vonë, ç’priste?”.

Influencuesit dhe figurat publike duhet të përdorin zërin e tyre për të luftuar këto paragjykime.

Përgjegjësia personale dhe kolektive

Secili prej nesh mund të bëjë diçka: Nëse shohim ngacmim në rrugë, duhet të reagojmë, jo të kthejmë kokën mënjane. Të mos përdorim më fraza si “vajzat duhet të ruhen” dhe ta zëvendësojmë me “djemtë duhet të mësojnë të respektojnë”. Të ndalojmë justifikimet për dhunën dhe të kërkojmë ndryshim të vërtetë në shoqëri.

Problemi nuk është tek vajzat, por tek ata që nuk e respektojnë lirinë dhe dinjitetin e tyre. Ndryshimi duhet të fillojë nga të gjithë ne!

A është ky një fenomen shqiptar?

Fatkeqësisht raste të tilla ndodhin shpesh, si në Shqipëri ashtu edhe në shumë vende të tjera. Vajzat fajësohen padrejtësisht në situata ku ato janë viktimat, qoftë për shkak të veshjes, orarit të daljes apo thjesht për faktin se janë gra në një shoqëri me standarde të dyfishta.

Në marrëdhëniet dashurore, një vajzë mund të etiketohet negativisht nëse ka më shumë partnerë, ndërsa një djalë në të njëjtën situatë quhet “i zoti” ose “i fortë”.

Fuqizimi i viktimave dhe denoncimi i padrejtësive

Vajzat dhe gratë duhet të ndihen të sigurta për të folur dhe për të kërkuar drejtësi. Shoqëria duhet të mbështesë denoncimet, jo t’i gjykojë viktimat.

Në fund të fundit, problemi nuk është vajza, problemi është shoqëria që justifikon dhunën dhe fajëson viktimën. Nëse duam ndryshim, duhet të fillojmë nga vetja dhe të mos heshtim kur shohim padrejtësi!

Po ti, a ke parë ndonjëherë një rast të tillë? Si ke reaguar?

“Një vajzë u përdhunua në mes të ditës nuk e pa askush. Një vajzë puthi një djalë në errësirën e natës dhe... e panë të gjithë”

Realitet i hidhur shqiptar dhe i hipokrizisë së shoqërisë sonë, që tregon se si dhuna dhe padrejtësia shpesh anashkalohen ose injorohen, ndërsa veprimet e lira dhe të padhunshme, si një puthje mes dy njerëzve, kthehen në objekt gjykimi dhe thashethemesh. Kur një vajzë është viktimë e një krimi të rëndë, askush nuk e sheh, askush nuk e ndihmon, askush nuk flet. Nëse një vajzë tregon afeksion apo liri personale, ajo menjëherë përballlet me paragjykime, thashetheme dhe gjykim moral. Kjo është një sagë, fundi i së cilës duket larg, përballë injorancës së thashethemit kolektiv, që me sa duket i paska rrënjët e thella në mentalitetin shqiptar.



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

*Xhezo Proda, i lindur në prehrin
e traditës luftarake dhe djepin e mençurisë labe*

Në djepin e mençurisë dhe trimërisë mes maleve labe është lindur 98 vite më parë Xhezo Dervish Proda. Ai erdhi në jetë në vjeshtën e parë (20 shtator, ditën e hënë) të vitit 1926, në vatrën e Prode në lagjen e Onjere në Fushëbardhë. Xhezo Proda rridhte nga një familje fushëbardhase me tradita luftarake, patriotike e atdhetare. Nga fisi dhe trangu familjar i Xhezos në vijimësi kishin luftuar me pushtuesit sa herë binte kushtrimi i luftës. Ato pak klasë fillore i mori në Fushëbardhë të Gjirokastrës. Çizmja e rëndë e pushtimit kishte pllakosur si në çdo fshat të Labërisë, edhe në vendlindjen e tij, Fushëbardhën. Mjedisi familjar me gjithë hallet e kohës ishte një unitet brezash, unitet familjar dhe të përbashkuar me bashkëfshatarët e bashkë-krahinorët e dy krahinave të Kardhiqit dhe të Rrëzomës nëpër shekuj në luftërat për liri, pavarësi dhe çlirim nga pushtuesit osmanë, grekë, italianë, austro-hungarezë e deri nazifashistët gjermanë. Në trangun familjar të oxhakut “Proda” janë të njohur në Fushëbardhë Kapo Proda me katër djemtë Ismaili, Dervishi, Fetani dhe Shemsiu. Kapua ishte martuar me Hatemen nga fisi Logli i Zhulatit. Ismaili ishte martuar me Hazbiye (Bije) Baze nga Peshtani i Tepelenës dhe kishin katër fëmijë dy djem dhe dy vajza: Aliun, Kasëmin, Sheko, Safife, si dhe Hazbon (me gruan e parë). Dervishi (Xhako i flisnin) ka qenë martuar me Zejnebi Bijo/Proda me të cilën lindën katër djem e dy vajza: Xhezo, Afife, Babuden, Siadete, Ulsi dhe Vehipi. Fetani martuar me Aleme Muçaj/Proda nga Vergoi; lindën dy djem Sherifin dhe Kapo si dhe tri vajza: Gaze, Haxho dhe Bezene. Shemsiu ka qenë martuar me Neko Shalari dhe patën dy djem: Tajarin, Lumanin. Pasi ndërroi jetë Nekua, Shemsiu u martua me Alemen nga Zhulati dhe lindën Xhemalin dhe Barjamin. Në rrethin më të afërt familjar të dëshmorit Xhezo Proda ishin tre vëllezërit dhe dy motrat e tij. Dervish Proda dhe Zejnebi Bijo/Proda i mëkuan bijtë e bijat e tyre me dashurinë për Atdheun dhe me etjen për liri, por edhe pasi ra në fushën e nderit biri i tyre gjithë pasardhësit mbajtën lart idealet patriotike dhe atdhetare sikurse ishin dhe mbetën atdhetarë: Afifja që u martua me Shefqet Golemin lindën Iblo, Shpëtim, Drita, Sabihe; Babudeni me Bele Cama/Proda lindën Republika, Dervish, Telha, Xhuljeta, Trifon dhe Kristina; Siadetja dhe Dervish Biro lindën Zurhanë dhe Eli; Ulsiu me Xhemo Hoxha/Proda nga Vergoi lindën Agimin, Fatmirin dhe Margaritën; Veipi me Theodhorën lindën Erjonin dhe Rudinën. Faktet vijnë nga kujtimet e nënës së dëshmorit Xhezo Proda, Zejnebisë që tregonte: “Kur lindi Veipi në shtëpinë tonë ishte gjëmë e madhe, sepse 3 muaj e gjysmë më përpara ishte vrarë Xhezua në Labinot...vetëm gjyshja Hatua kujdesej për vëllanë ...Xhakua e donte për mendje të kokës...i urtë, punëtor, i zgjuar, i dashur, ...i pjekur para kohe, i vendosur si Xhakua (i ati) ...lufta mori djem në qemal dhe ajkën e djalërisë edhe për Fushëbardhën e Labërinë”. Një oxhak i madh me rrënjë lisi me vlerë trashëgimie atdhetarie, që i bëjnë nder fshatit, trevës labe. Nga të gjithë fëmijët e Dervish Prodës, vetëm Xhezua “u martua” me lirinë dhe ngeli në përjetësi si meteor ndriçues e frymëzim për brezat. Kur lindi Xhezua Shqipëria jetonte “Republikën e parë”. Xhezua i etur për dije mësoi shumë që fëmijë për vendin e sapo dalë nga një kompleksitet ngjarjesh të pavarësisë së shtetit të 1912-tës, të luftës me andartët (1913-1914), ku dha jetën edhe komandanti i çetës së Fushëbardhës në Skërficë Halil Huto Sullo/ose Proda, sepse Sullajt dhe Prodajt ishin nga një “vatër-zjarri” të një oxhaku. Xhezua mësoi edhe për Luftën e Madhe (1914-1918), ku shkeli këmba e mbi 250 mijë ushtarëve të 7 ushtrive të huaja, të ngjarjeve madhore të Kongresit të Lushnjës dhe Luftës së Vlorës të 1920-ës, ku nga çeta e Fushëbardhës me 78 jatanë/luftëtarë ishin edhe djemtë e oxhakut “Proda”, luftëtarët e fisit të Xhezos ishin babai i tij Dervish Proda, Xiflo Proda, Jupe Proda etj., për Fushëbardhën e Fushëvërrinë. Familja ku erdhi në jetë Xhezua ishte e nderuar dhe e respektuar në fshat dhe krahinë, por vlerat ia shtoi edhe më shumë gjaku i derdhur për lirinë e Shqipërisë, duke konsoliduar vijimësinë patriotike të fisit.

Xhezo Proda – luftëtar lirie që në moshën 16 vjeçare

Xhezo Proda u bë pjesë e formacioneve partizane që nga fillimi i krijimit të formacioneve partizane. Prushi i zjarrit të luftës partizane ishte ndezur pas pushtimit në të gjithë Shqipërinë. Sikurse në të gjithë vendin në fshatin e Xhezos, në Fushëbardhë më 12.12.1942, u krijua formacioni i parë partizan çeta partizane “Çerçiz Topulli” ndër të para çeta partizane në Shqipëri, kur

XHEZO PRODA, DËSHMOR I ATDHEUT, KRENARI E KOMBIT SHQIPTAR



Xhezo Proda ishte vetëm 16 vjeç. Kujtimet e shkruara nga Resul Bedo dhe Islam Idriz Poçi janë të gjalla për Xhezon që transmetohen që kur Xhezua u aktivizua me rininë antifashiste, me çetën, batalionin partizan, kur shpërfillën vitet e pakta të moshës, kur shkoi vullnetar në çetë e në batalionin “Asim Zeneli, kur mori pjesë në të gjithë luftimet e batalionit, kur u shqua për trimëri dhe guxim, kur u përbashkua dhe u rreshtua me forcat e BrVIS”. Bashkëfshatarët dhe bashkëluftëtarët kanë shkruar epopenë e madhe të luftës, luftimet e përgjakshme, përballjen e Xhezo Prodës dhe luftëtarëve të tjerë me topat e mitralozat, me autobлиндat dhe pajisjet më moderne të kohës nga ana e pushtuesve nazifashistë. Në luftën e përgjakshme të tre ditëve të Labinotit ku forcat e tre batalioneve gozhduan autokolonat armike por ndërkohë që pushtuesi la shumë të vrarë (që i ka deklaruar vetë), forcat partizane patën 11 heronj lirie, përfshi dhe djalin 18 vjeçar nga Fushëbardha Xhezo Proda. Në Labinot përfundoi aktivitetin luftarak Xhezo Proda, pjesëmarrës në katër formacione partizane, dhe në të gjitha luftimet nga Fushëbardha në Elbasan. Në luftimet e brigadës së gjashtë sulmuese në Labinot u vranë 11 partizanë meteorë lirie: Xhezo Proda, Balil Peçi, Luto Çani, Sulo Baka, Halil Halilaj, Neki Hasani, Bajram Lalaj, Riza Çani, Tefik Selaj, Jonuz Balilaj, Merdan Kalemaj dhe u plagosën 21 të tjerë. Gjurmët e 11 dëshmorëve të Labinotit zënë një vend nderi në rrugëtimin luftarak dhe historikun e brigadës së gjashtë sulmuese. Në këtë luftë u plagos për vdekje dhe Arif Bizhga (nga Kaparjeli), që për momentin u përllogarit si “i vdekur”, por lëvizja e gishtave e shpëtoi dhe u mjekua si dhe jetoi gjatë. Arifi, që ishte shok i Xhezos, ngeli invalid lufte, pasi e çuan urgjent në shtëpinë e Sami Bahollit, ku shërbente mjeku italian, Mario, i cili e pa “të vrrarin” dhe tha:

“është shumë rëndë është, por do bëjmë çmos ta shpëtojmë”. Në fakt shok i armëve të Xhezos jetoi për të treguar epopenë e trimërisë së bijve të Labërisë në betejën e Labinotit. Luftëtarët e rënë u varrosën në Labinot me një ceremoni solemne, ku mori pjesë edhe populli i fshatit Labinot. Në xhepin e dëshmorit Xhezo Proda shokët i gjetën një letër që e dërgonte nëna e tij: “Bir i nënës, Xhezo. Po bëhet mjaft kohë që s’të ka parë nëna e shkretë. M’u dogj zemra, jemi dit e net në zjarr, po as unë as nënat e shokëve të tu nuk trembemi. Bjeruni fashistëve, se na shkretuan vendin, që u shkretofshin dhe një mos mbettë...”. Për luftën e Labinotit është folur e shkruar shumë, ndërsa ka shkruar edhe ish-oficeri nazist gjerman në këtë luftë Herman Frank: “Aty ka më shumë humbje se sa në njësitë e angazhuara në luftë kundër çetave. Spitali në Elbasan është mbushur plot me të plagosur dhe të vrarët nëpër varreza sa vijnë dhe shtohen” (Herman Frank, “Bandenkampfe in Albanien”, Heidelberg, 1957, faqe 91). Luftimet në këtë periudhë në Labinot drejtoheshin nga komandant Jaho Gjoliku dhe komisar Haki Toska. Fakt është se lufta antifashiste partizane në Fushëbardhë, në fshatin e Xhezos gjeti shtëpinë e saj të lirisë, pasi Fushëbardha u hodh masivisht në luftë për liri dhe çlirim, me mbi 120 partizanë nga të cilët 15 ranë dëshmorë të pavdekshëm të lirisë. Në Fushëbardhë, gjatë luftës u krijuan Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar (10.11.1942), çeta “Çerçiz Topulli”(12.12.1942), Komanda e vendit, depot e ushqimit dhe municionit, Spitali partizan, Këshilli i Gruas Antifashiste (17.1.1943), batalioni territorial i krahinës së Kardhiqit, me komandant Karafil Bello. birin e krahinës të fshatit Fushëbardhë (Cepo më 31.7.1943); batalioni “Abaz Shehu” (12.12.1943), pas ndarjes me batalionin “Asim Zeneli” që ishte krijuar tek rrapet e Kardhiq-Prongjisë (7.8.1943). Pas vrasjes

së komandantit të batalionit të rinisë Karafil Bello, më 2 shkurt 1944, te Çuka e Kuqe në Senicë, batalioni i rinisë u bë pjesë e Grupit të parë partizan të ZIOp dhe u emërtua batalioni “Karafil Bello”. Gjithë zhvillimet në Fushëbardhë Xhezua i ndoqi deri në ditën që u shua, pasi shpirti dhe mendja e tij ishte trupëzuar me vendlindjen. Fushëbardha me rrënjë të thella të lirisë, e donte Xhezon dhe gjithë dëshmorët e saj në tokën e vet, por vendimet e kohës ngritën varrezat e dëshmorëve të rrethit, ashtu sikurse janë 36 grup-varrezash të dëshmorëve në të gjithë Shqipërinë. Përpjekjet për të marrë eshtrat u bënë nga babai i tij Dervishi që në vitin 1947, që kishte kërkuar të merrte eshtrat e djalit në Labinot të Elbasanit. Kohët kishin ndërruar. Nuk praktikohej më tradita zakonore e varrimit të dëshmorëve, “ku i zinte balta”. Kështu që një vit më vonë, më 1948 i vëllai i dëshmorit, Babudeni shkoi në Elbasan. Katër vite e kishte ruajtur toka të patretur, si duket amaneti i lirisë. Ai shprehej: “Unë isha i madhi, megjithëse Xhakua e trajtonte Xhezon si të madh që kur ishte i vogël; ...kur i ngritëm nga toka eshtrat e tij m’u duk sikur më tha: “ç’ bëni more se më dërmuat! Xhezon e pashë edhe një herë si të gjallë”.

Brigada partizane e Xhezo Prodës, Brigadë “Hero i Popullit” (26 janar 1944)

Në Fushëbardhë në tetë dekada për brigadën e gjashtë sulmuese ose “Brigadën e Labërisë”, thuhej “Brigada ku luftoi Xhezua, Alemi, Tahiri, Kutbiu, Latifeja...”, ndërkohë që brigada ishte sikurse është etiketuar, “Brigada që tundi dhenë./në popull ngriti folenë,/atje jataku dhe shpirti,/lavdinë më lartë e ngriti./... Brigada e VI-të u themelua nga shkrirja e çetave “Çerçiz Topulli”, “Hajredin Tremishti”, “Avni Rustemi” dhe “Toto Bolena”, edhe pse fakt është se brigada u krijua mbi bazën e 4 batalioneve. Me këto çeta u krijua batalioni “Asim Zeneli”. Brigada VI sulmuese ishte formacion lavdie i UNÇSH-së, që gdhendi emrat e partizanëve dhe dëshmorëve në historinë e kombit tonë. Batalioni “Asim Zeneli” i krijuar në rrapet e Kardhiqit e Prongjisë më 7.8.1943, batalioni “Baba Abaz”, krijuar në Kalivaç të Tepelenës më 10.8.1943, batalioni “Naim Frashëri” në Garzema të Përmetit më 21.9.1943, batalioni “Abaz Shehu” i krijuar më 12.12.1943 në Fushëbardhë, pas ndarjes së batalionit “Asim Zeneli”, si dhe batalioni i pestë ishte batalioni partizan “Zaho Koka”. Partizanët e këtyre batalioneve kishin marrë pjesë në luftimet kundër forcave fashisto-naziste si në Cepo, Ura e Kardhiqit, Libohovë, Shkallë të Zezë, Tepelenë, Mezhgoran, Kiçok, Rrëzomë, Kurvelesh, Mesaplik etj., u përfshinë në BVI Sulmuese, përveç batalionit “Misto Mame”, i cili u inkadrua më vonë në brigadën VIII Sulmuese. Këto batalione kishin përshkuar një rrugë të vështirë e të lavdishme luftarake. Ato i kishin shkaktuar armikut qindra të vrarë, të plagosur e robër, kishin kapur shumë materiale luftarake, armë automatike, pushkë, topa, murtaja e municione të shumta. Formimi i brigadës VI Sulmuese gëzonte jo vetëm partizanët, por edhe popullin e qarkut të Gjirokastrës. Në thirrjen e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Qarkut thuhej: “Edhe në Gjirokastrën tonë të çëcove të vjetër e të rinj, do të formohet Brigada VI Sulmuese. Ata që përbëjnë këtë brigadë janë djemtë e krahinës dhe të qarkut tonë, që me gjakun e tyre kanë çliruar zona të tëra e do të vazhdojnë për ta shkatërruar armikun plotësisht”. Brigada e VI Sulmuese “Heroinë e Popullit”, që numëronte 912 partizanë nga të cilët 120 vajza e gra dhe 60 pionierë lufte, ndërkohë që efektiv i saj u rrit në 1700 luftëtarë. Drejtuesit e brigadës e shkruan biografinë e tyre me luftime të përgjakshme, por të suksesshme. Në kohën e krijimit BrVIS kishte: komandant Tahir Kadareja, nënkomandant Jaho Gjoliku, komisar Mustafa Matohiti, zv/komisar Haki Toska; me seksionin politik Adil Çarçani, Zihni Sako, Sami Gjebero, Siri Çarçani, Vangjelo Sotiriadhi, intendentë: Hetem Pogaçe e ndihmës Braho Toto, për shëndetësinë Nedin Kalanxhi, ndihmësmjek, për ndërlihdjen Muhedin Bakiri, komandantë batalionesh ishin Riza Veipi, Sadik Buzo, Fejzo Ismaili, Feti Bubsì, Maksut Myrtaj, nënkomandantë batalionesh: Astrit Nishani, Musa Daci, Mustafa Asllani, Meleq Gostinishti, zëvendëskomisar batalionesh Ago Çeli, Veledin Zeneli, Petrit Radovicka, Mitro Xhani, Abdul Hakiu, Asaf Dragoti, e kuadro të tjerë si Sotir Filto, Xhule Çiraku etj., që spikatën në betejat e shumta të kësaj brigade. Lufta e partizanëve të BrVIS çliroi 8 qytete e 32 krahina, që përmes luftimesh të përgjakshme të 5 batalioneve të saj në një rrugëtim historik luftimesh prej 3700 km ndoqi nazistët deri në Vishegrad, por la në fushën e nderit 220 “Dëshmorët të Atdheut” dhe 10 “Heronj të Popullit” që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë, por që pati edhe 540 partizanë të plagosur, disa nga të cilët ndërruan jetë nga plagët e marra në luftë dhe që në bazë të ligjit meritojnë titullin e lartë “Dëshmor”. Nga Fushëbardha ka pasur me dhjetëra bijë e bija që kanë ngelur emra të gdhendur në historinë kombëtare, ku vetëm nga Fushëbardha kanë rënë dëshmorë nga formacioni i BrVIS: Alem Zano Shehu dhe Tahir Reis Xhuvani (15.4.1944), Kutbi Çelo Gjeçi (25.7.1944), Xhezo Dervish Proda (10.9.1944), Latife Veli Nora (25.3.1945) në Suhagorë të Bosnje-Hercegovinës. BrVIS ishte formacion nga më të lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që u shndërrua në simbolin e rezistencën antifashiste të shqiptarëve. Me betejat e zhvilluara kjo brigadë shkroi me germa të arta historinë e saj. Shqipëria ishte ndër vendet e para të Europës, që u çlirua tërësisht nga pushtuesit nazifashistë, si një meritë të padiskutueshme i takon partizanëve të Brigadës VI Sulmuese, që u bë Brigada epope lavdie e LANÇ-it, që luftoi 308 ditë lufte në Shqipëri dhe 371 ditë të tjera lufte në ish-Jugosllavi. Nuk është e rastit që analistët

e luftërave thonë se, “pa LANÇ-in, nuk do ekzistonte Shqipëria”, pasi epopeja e luftërave në botë ka fshirë mjaft kombe e popuj nga faqja e dheut. Ndërkohë që epopeja shqiptare e luftës çlirimtare dhe antifashiste është çimentuar me gjakun e dëshmorëve të Fushëbardhës, Labërisë, gjithë Shqipërisë. Brigada ku luftoi Xhezo Proda lindi u rrit dhe u konsolidua në zjarrin e betejave për liri gjatë LIIB, ku UNÇSH shkroi historinë e një prej luftërave më të organizuara të shqiptarëve, që vendosi shqiptarët në anën e duhur të historisë, përfshi librat e historisë së evropianëve dhe euro-atlantikasve si lufta e përbashkët antifashiste çlirimtare e popujve. Prandaj dhe oshtima e këngës vazhdon: “Dil nëno dhe shiko jashtë,/si lufton Brigada e gjashtë./Trimat tanë të Shqipërisë,/sollën dritën e lirisë,/në këtë tokë plumb të rëndë./me mençuri, pushkë dhe këngë... Është kjo arsyeja që epopenë madhështore të çlirimtarëve nuk mund të nëpërkëmbë asnjë lloj ferre që ka në thelb antishqiptarizmin. LANÇ-i në historinë e kombit ishte dhe do ngelet e ndritshme në historinë e shqiptarëve, sepse mbi të gjitha është gjaku i dëshmorëve në rrënjët e lirisë.

Në Fushëbardhë të Labërisë, ku bashkudhëtarë janë historia, atdhetaria, kombi

Dëshmori Xhezo Proda jetoì pak, por la gjurmë të thella në memorien krahinore dhe kombëtare si pjesë vitale e antifashizmit shqiptar. Xhezua mësoi shumë për Fushëbardhën e tij të dashur nga prindërit e tij të mirë. Kështu që kur qe fare fëmijë mësoi se, Fushëbardha, një fshat i Labërisë mes malesh, ishte një djep mençurie, trimërie e lavdie në krahinën e njohur të Kardhiqit, e lidhur pazgjidhshmërisht me krahinën e përtej qafës së Skërficës, me Rrëzomën. Njerëzit janë si malet, të rrahur mes erërash e rrebeshesh të kohës, që historia i vuri përballë sfidave të shumta. Fushëbardha ka një terren karakteristik me kodra, lëndina, ujëra, male që i rrinë si kurorë fshatit. Me shumicë në këtë fshat gjenden edhe gjurmët më epike, histori të shkruara, të thëna dhe të pathëna, me episode legjendare, me njerëz të mençur, të besës dhe të fjalës, që përbëjnë krenari të dukshme labe e kombëtare, vendi i vatrave të ndezura, vendi ku përkunden ëndrrat, i mirësisë, ku ka mbetur dhe do mbetet në piedestalet e kujtesës njerëzore e krahinore, ngjarjet, tragjeditë, hallet e kohës, sfidat, perspektiva. Kushdo në Fushëbardhë dhe jo vetëm i “lexonte” shekujt të shkuar nëpër luftëra, prandaj kanë një traditë të pasur e të çmuar, sikurse kanë traditë në mençuri, në punë, në kuvende dhe në përballimin e halleve e brengave të jetës. Shtëpitë janë të mbledhura në shtatë mëhalla tej e këtej lumit, që e ndan dhe e përbashkon fshatin që shtrihet mes bardhësisë, kaltërsive dhe gjelbërimit. Ky lumë bashkë me përrenjtë që e “furnizojnë në prurje” janë paksa të “krisur e kokëshkretë”, të rrëmbyeshëm, që popullsia e fshatit ia njuh “huqet” dhe historitë e çuditshme, ia njuh këngët e vajt e jetës, ia ka parë sherret me përmytje e dëme, si dhe kapërcimin e mundësive të kontrollit këtej e matanë kufirit normal. Nga fundi i Hingës tek gryka e Shurit është lëmi i halleve, brengave, sfidave. Njerëzit dinë t’i mbajnë dhe t’i përballojnë njerëzishëm dhe në mënyrë të fisnikëruar gjithë sfidat. Fiset e Fushëbardhës janë të shumta, shtrihen në një fushë të bardhë nga zalli i bardhë i lumit, një fushë e bardhë që e ka vendosur vetë emrin. Banorët e mençur të Fushëbardhës, sikurse gjithë treva e Cepos, krahinës së Kardhiqit dhe mbarë Labërisë janë të përhapur anë e mbanë Shqipërisë, ndërsa sot janë “banorë të planetit”, pothuaj në të gjitha kontinentet. Punën, jetën dhe sidomos shkollimin e quanin “detyrë dhe detyrim për të gjithë”, prandaj i janë “qepur” fuqishëm dhe kanë mundësuar që ta rregullojnë disi jetën. Askush në këtë fshat nuk ndihet si “njeri pa njeri”, as të rënë e shumtë, që ranë për ideale të larta si: Xhezo Proda, Latife Nora, Karafil Bello, Sami Golemi, Tahir Xhuvani, Alem Shehu, Baxhul Nora, Zijadin Çarçani, Kutbi Gjeçi, Nishat Kondi, Gazi Kondi, Cirok Cama, Destan Nora, Mato Mato, Tajar Proda, 15 dëshmorë vetëm të LANÇ-it. Ata janë në qendër të fshatit, përjetësisht të gdhendur në memorial, që “presin” dhe “përcjellin” njerëzit, por dhe kohët e stuhishme të lavdisë që nuk harrohen dhe perspektivën e re të zhvillimit të këtij fshati. Nuk është e rastit edhe letra e ngushëllimit që ish-Kryeministri Adil Çarçani (bashkëluftëtar me Xhezo Prodën gjatë luftës) i dërgoi më 11.2.1985, vëllait të Xhezos, Hulsit për humbjen e nënë Zenebisë, “...Ishte njeriu i dashur jo vetëm për zemrat tuaja, por edhe për të gjithë ne që e njihim dhe e donim shumë. Ajo qëndroi gjatë LANÇ-it me vendosmëri dhe me gjithë dëshpërimin që pati me humbjen e Xhezos, nuk u ligështua, por vazhdoi deri në fund me trimëri...”. Dëshmi e njohur e luftës ishte takimi i fundit me familjarët i Xhezos në prill 1944 kur BrVIS kryente veprime luftarake në Rrëzomë deri në Bajkaj, kur nëna i thotë, Xhezos së fejuar, “nëse vritesh nusen o Xhezo do ta marrin bota”. Amaneti i tij ishte: “nëse vritem kam vetëm një amanet: nusen le ta marrë një partizan”. Kështu ndodhi në të vërtetë. Fakt është se vdekja e Xhezos në fushëbetejë u mësua në nëntor 1944, kur vëllai i tij Hulsiu ishte me bagëti në Vale të Zhulatit tek Kroi i bardhë dhe vaji ishte çelur tek shtëpia e Ali Prodës, sepse shtëpia e Dervish Prodës ishte e djegur. Ndërkohë që në shtator deri në nëntor, dhjetë vetë të caktuar nga Komanda e vendit në Fushëbardhë transportonin materiale luftarake e ushqime për partizanët si Ali Proda, Ulusi Proda, Fero Golemi, Namik Veliu, Bajo Onjea, Nazif Kondi, Shaban Mema, Qerim Proda, Eqerem Miho dhe Hodo Basho që ishte plagosur në dorë në Pilur dhe që Komanda partizane kishte vendosur ta dërgonte në Bari të Italisë për kurim në

Shtabin Aleat të Mesdheut. Skuadra që transportonte municion kryesisht nga gryka e Palermos në Vumlo të Pilurit dhe më tej në Kuç të Kurveleshit. Një kontribut i çmuar dhe i shquar për luftën e Fushëbardhës, që zor se shkruhen të gjitha detajet e saj. Fushëbardha është fshati i 62 dëshmorëve dhe të rënëve të njohur juridikisht dhe të përfaqësuar në qendër me dy lapidarë: një për luftën e 1914-ës dhe një të dëshmorëve të LANÇ-it. Për Dëshmorët e lirisë flet historia. Dëshmorët nuk kanë punë me “zyrat shtetërore”, “tufat shkresore, nenet e ligjet, vendimet, nuk kanë nevojë për mbrojtje”. Dëshmorët si Xhezo Proda e bënë veprën e tyre për së gjalli, nuk interesohen se “sa i gjatë të jetë litari”, kur gjuha e të gjallëve ia kalon çdo litari. Dëshmorët bënë historinë me gjak. Ata falën jetën pa temenara, pa kërkesë, por me dëshirë e vetëdije atdhetare, ndërkohë që për ditët tranzitive që rrodhën në Shqipërinë tonë Dritëro Agolli i madh thoshte: “E mira dhe e keqja flenë nën një jorgan, por çështja është se zgjohen në kohë të ndryshme...”. Në Labëri ndoshta ka fshatra me një “shoshë” qiell, por njerëzit e kësaj treve janë të fortë si shkëmbi, trima dhe të besës me shtëpi kala, që në luftëra u thoshin “shtëpi pushke, me karakteristikat të rralla unitetin, që për luftën antifashiste merituan dekoratat e Trimërisë, Kujtimit dhe të Çlirimit, duke lartësuar krenarinë kombëtare. Trungu familjar i fisit Proda është një prej 56 fiseve të Fushëbardhës, është pjesë e vetëdijes, rezistencës, trimërisë, mençurisë të Fushëbardhës, Cepos, Krahinës së Kardhiqit dhe Rrëzomës bashkë, Labërisë. Oxhaku i Prode ka nxjerrë bijë e bija që me vetitë dhe virtytet e tyre janë trupëzuar me mëmëdheun, atdhetarinë, kombin, kanë qenë dhe kanë mbetur misionarë të shqiptarizmsë.

Xhezo Proda dhe dëshmorët e tjerë të fshatit në këngët dhe përjetësinë popullore

Xhezo Proda i plagosur rëndë do diktonte fjalët e fundit për nënën: “Nënë e dashur, ndoshta nuk do ta shikosh më birin tënd, por e di që ti do të qëndrosh kryelartë si dhe nënat e tjera shqiptare, që humbën bijtë e bijat e tyre në luftë dhe të jesh krenare se biri yt vdes si një partizan...”. Bijua (kështu i flisnin në fshat nënës së dëshmorit Xhezo Proda), e vajtonte djalin e saj: “Luftë e madhe atë ditë,/ luftuat me pushkë e thikë,/Ç’ të të them Xhezo o djalë, / Të mori plumbi gjerdanë,/ zorrët në shesh të ranë,/ gurët në gjak u lanë, /Xhezair bir o bir!” Për Xhezon kënduan këngë dhe në Labinot: “Lule, Xhezo Proda, pushka jote top”, në gazeta e revista emri i tij ishte emër krenarie. Poeti Zeqir Cama në gjashtë strofa ka derdhur talentin e tij për dëshmorin Xhezo Proda: “Plag’ e vetme qe e rëndë, Ndër dy brinjë si goj’ e kuqe,/ E mbajte shpirtin me dhëmbë,/Për të bërë ca rrugë tutje,/ Batalioni mori urdhër,/Të nisej dy orë pa gdhirë,/Trupi yt si nur i bukur,/Në krah shokësh rrinte shtrirë,/Një nga një të gjithë me radhë,/ gjetën kohë dhe bënë betimin,/ Bashkëfshatarët në Fushëbardhë,/ Gjer aty nuk mund të vinin,/ Të merrnin pak në duar,/ Se i kishte marrë malli,/Të qafosnin përmalluar,/Xhezo Ylli, Xhezo djali!... more Xhezo bukuria...”. Ndërsa në “Kënga e dëshmorëve të fshatit Fushëbardhë”, kënduar nga Guro Golemi/ Resuli (bijë e dëshmorit Sami Golemi): “Ç’ligje ligjërove,/ Ti moj Fushëbardhë? /Prite e ç’nuk prite,/ Pesëmbëdhjetë të vrarë.../ Ç’i tha nëna Xhezos, Gjith’Prodajt ç’i thanë?/djalë hallall gjinë,/ se re për vatanë...”. LANÇ-i ishte dhe mbetet epopeja më e lavdishme e të gjitha luftërave që kanë zhvilluar shqiptarët shekujve dhe padyshim nuk ka forcë që ta fshijë nga historia, rrezet e së cilës flakërojnë bindshëm mbi të gjithë ata që kanë sy e veshë. Sikurse thekson profesori Nexhip Alpan, bashkëfshatar i Xhezo Prodës: “Dëshmorët përbëjnë themelin e ekzistencës së kombeve të një populli e vendi, dhe se shqiptarët janë më i hershmi i viseve të Ballkanit, tërë jetën e ka kaluar në luftë, asnjë popull tjetër në Ballkan e kontinent s’ka dhënë kaq dëshmorë, sa kombi shqiptar. Popullin shqiptar dëshmorët e kanë bërë komb!”. Veteranët, pasardhësit, nipa e mbesa të dëshmorëve të luftës partizane, do të dinë të mbrojnë brez pas brezi LANÇ-in, vlerat e simbolet e saj, që shqiptarët në mes-shekullin e kaluar i renditën krah fitimtarëve. Duke vlerësuar aktivitetin e madh politiko-luftarak të Brigadës VI Sulmuese Presidiumi i Kuvendit Popullor i akordoi asaj urdhrin “Ylli partizan i klasit I” dhe dekoratën më të lartë: “Hero i Popullit” me këtë motivacion: “Për plotësimin me heroizëm të lartë dhe vetëmohim, të detyrave të saj të mëdha luftarake e politike, për kontributin e shquar në çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë e tradhtarë dhe në vendosjen e pushtetit popullor. Ajo ka luftuar gjithnjë me trimëri të rrallë dhe ka treguar një besnikëri të pakufishme ndaj popullit e Partisë, duke korrur fitore të shkëlqyera mbi armiqtë dhe duke mbajtur gjithnjë lart emrin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ajo ka kryer, gjithashtu, me nder dhe me frymë të thellë internacionaliste detyrën që i ngarkoi Komanda e Përgjithshme, tok me njësi të tjera të UNÇ-së Shqiptare, për të ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë. Shembulli i lartë i heroizmit dhe i vetëmohimit të saj ka frymëzuar gjithë luftëtarët partizanë dhe frymëzon sot punonjësit e vendit tonë, sidomos rininë, në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste dhe mbrojtjen e atdheut socialist”, motivacion që vjen sipas origjinalit. Xhezo Proda ishte dhe mbeti pjesë përbërëse e trupëzuar e kësaj krenarie. Eshtrat e Xhezo Prodës prehen në Gjirokastrë në piedestalin ku nderohen të rënë e kombit shqiptar. Xhezo Dervish Proda është shpallur me titullin e lartë të nderit “Dëshmor i Atdheut” me Vendim të KE të KP të rrethit Gjirokastrë nr. 65 datë 2.10.1971 si dhe është njohur në bazë të ligjit dhe Vendimit nr.4 datë 27.11.2002 të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Ajsbergu më i madh në botë po shembet

Është më shumë se dyfishi i madhësisë së Londrës së Madhe. Por ajsbergu më i madh në botë, i njohur si A23a, ka filluar të shkrëmoqet.

Imazhet satelitore zbulojnë se një pjesë e madhe është shkëputur nga megabergu, i cili ka qenë duke udhëtuar vazhdimisht në veri në Oqeanin Atlantik Jugor.


Fragmenti i dhëmbëzuar ka një sipërfaqe prej afërsisht 31 milje katrorë (80 km katrorë), vetëm një pjesë e rreth 1297 milje katrorë (3360 km katrorë) që ka mbetur.

“Kjo është padyshim pjesa e parë e qartë e ajsbergut që është shfaqur”, - tha për AFP Andrew Meijers, oqeanografi në Antarktikun Britanik (BAS).


“Është vërtet e vështirë të thuhet nëse kjo do të shpërthejë tani, apo do të qëndrojë së bashku për më gjatë”.

Ajsbergu peshon rreth një trilion tonë - rreth 100 milionë herë më i rëndë se Kulla Eifel në Paris, dhe tani po udhëton në veri drejt Gjeorgjisë Jugore me një shpejtësi prej rreth 30 milje në ditë.

Ekspertët janë të shqetësuar se mund të vrasë kafshë të egra si pinguinët dhe fokat kur të arrijë në Gjeorgjinë Jugore, ishullin në Oqeanin Atlantik Jugor.



Ajsbergu kolosal, i cili dikur ishte më shumë se dyfishi i madhësisë së Londrës së Madhe dhe peshonte gati një trilion tonë, kishte mbetur kryesisht i paprekur që kur filloi të lëvizte ngadalë në veri në vitin 2020, por një pjesë rreth 12 milje (19 km) e gjatë, është shkëputur.



Ky imazh satelitor tregon ajsbergun A23a në formë dhëmbi përpara se pjesa e parë e madhe të shkëputej në fund të janarit 2025

Z. Meijers, i cili u ndesh me ajsbergun në fund të 2023 dhe e ka gjurmuar atë me satelitë që atëherë, e quajti A23a një “mur i madh akulli i stilit të Game of Thrones”.

“Me disa valë që shpërthejnë kundër tij dhe nëse ju vjen pak diell, është vërtet dramatike”, - tha ai.

Për çdo pjesë të ajsbergut mbi sipërfaqen e ujit, ka 10 herë më shumë poshtë, sipas ekspertit.

Në të kaluarën, mega-ajsbergë të tjerë ishin shkatërruar “shpejt gjatë disa javëve”, pasi filluan të humbnin pjesë të mëdha.

Është e vështirë të thuhet nëse ky ishte “një dhëmb i liruar që sapo priste të dilte, apo dëshmi e një ndryshimi shumë më të madh në zhvillim”, -tha ai, si shpërbërja e plotë.

Ekspertët tani do të hedhin një sy vigjilent për të parë nëse A23a shpërthen përpara se të përplaslet me Gjeorgjinë e Jugut, një terren thelbësor ushqimor për foka dhe pinguinët.

Ka një shans që ajsbergu i madh mund të prishë për fat të keq rutinat e të ushqyerit të kafshëve të egra, për shembull, nëse parkohet në një zonë ku zakonisht ndodh kërkimi i ushqimit.

Në mënyrë shqetësuese, ajsbergët që kishin ‘tokëzuar’ ose ishin bërë të palëvizshëm në Gjeorgjinë Jugore në të kaluarën vranë zogj pinguinësh dhe këlyshë fokash.

Si formohen ajsbergët?

Një ajsberg është një copë akulli i ujit të ëmbël që është shkëputur nga një akullnajë dhe po noton në oqean.

Ajsbergët formohen kur copa akulli shkëputen nga fundi i një masivi akulli ose një akullnaje që derdhet në një trup uji.

Ky quhet “pjellje” dhe është një proces natyror që është përgjegjës për humbjen e akullit në skajet e akullnajave dhe shtresave të akullit.

Nëse shembet më tej, do të përbënte një kërcënim shumë më të vogël për jetën e egër, sepse kafshët kërkimore mund të manovrojnë midis copave më të vogla.

Trajektorja e Bergut drejt Gjeorgjisë Jugore nuk ka gjasa të ndryshojë vetëm sepse e ka humbur këtë pjesë, shtoi Meijers.

Soledad Tiranti, një akullnajolog aktualisht në një udhëtim argjentinas në Antarktik, tha gjithashtu për AFP se një pjesë ishte “shkëputur”.

Ajsbergu pritej të vazhdonte të shkonte në veri, por kursi i tij i saktë varej shumë nga ndikimi i rrymave lokale në lëvizjet e tij, shtoi Tiranti.

A23a është fragmenti më i madh i mbijetuar i një ajsbergu që u shkëput nga rafti i akullit Filchner i Antarktidës në gusht 1986.

Ai kishte lëvizur vetëm disa qindra milje kur u mbërtheye, ose “u ngul” në fundin e oqeanit dhe përfundoi, duke u bërë i palëvizshëm për 30 vitet e ardhshme.

Ajsbergët “tokëzohen” në fundin e oqeanit kur keelja e tyre (pjesa nën sipërfaqen e ujit) është më e thellë se thellësia e ujit.

A23a më në fund u çlirua në vitin 2020 dhe filloi të lëvizte drejt veriut, megjithëse udhëtimi i tij është vonuar herë pas here nga forcat oqeanike që e mbanin atë të rrotullohej në vend.

Ky bllok përbindësh i ujërave të ëmbla po lëvizet nga “rryma më e fuqishme e oqeanit” në botë, Rryma Rrethore e Antarktikut.

Pjesë të ajsbergut po shkëputen ndërsa shkon më në veri, për shkak të erozionit dhe shkrirjes nga ujërat e ngrohta.

Ashtu si erozioni bregdetar i tokës, valët po përplasen me ajsbergun për t'i bërë boshllëqet që rriten vazhdimisht derisa maja të shembet.

Kjo lë “pirgje” të vogla të cilat më pas formojnë “cungje” më të vogla përpara se të shkrihen plotësisht.

“EYOS Expeditions”, e cila mbërriti në A23a në janar të vitit të kaluar, vendosi një dron për të marrë disa foto mahnitëse të megabergut nga ajri.

Videografi i EYOS, Richard Sidey, tha se A23a është “çuditërisht i madh dhe shtrihet aq sa mund të shihni në të dy drejtimet”.

“Në fakt nuk mendoj se mund ta kuptojmë se sa i madh është; ne mund ta dimë se sa i madh është vetëm nga shkenca”, - tha ai.

A23a është aktualisht ajsbergu më i madh në botë, por ky titull nuk do të zgjasë përgjithmonë, sepse të gjithë ajsbergët përfundimisht fragmentohen.

Ish-mbajtësi i rekordit ishte A76, i cili u shkëput nga një masiv akulli në Detin Weddell në maj 2021, por që atëherë u nda në copa.

Çfarë janë ajsbergët dhe pse janë të rëndësishëm?

Ajsbergët janë copa akulli të ujërave të ëmbla më shumë se 50 metra të gjata që janë shkëputur nga një akullnajë ose një masiv akulli dhe janë duke notuar lirshëm në ujë të hapur.

Ajsbergët që shkëputen nga një masiv akulli tashmë lundruen nuk e zhvendosin ujin e oqeanit kur shkrihen, ashtu si shkrirja e kubeve të akullit nuk e ngre nivelin e lëngut në një gotë.

Disa ajsbergë përmbajnë sasi të konsiderueshme të sedimentit të pasur me hekur, i njohur si “akulli i pistë”.

“Këto ajsbergë fekundojnë oqeanin duke furnizuar me lëndë ushqyese të rëndësishme organizmave detarë si fitoplanktoni”, - tha Lorna Linch, pedagoge e gjeografisë fizike në Universitetin e Brighton.

Ajsbergët gjithashtu mund të përbëjnë rrezik për anijet që lundrojnë në rajonet polare, siç u demonstrua në prill 1912, kur një ajsberg çoi në fundosjen e RMS “Titanic” në Oqeanin Atlantik të Veriut.

Ajsbergët mund të arrijnë një lartësi prej më shumë se 300 këmbë mbi sipërfaqen e detit dhe të kenë masë që varion nga rreth 100,000 tonë deri në më shumë se 10 milionë tonë.



Ajsbergu, i njohur si A23a, më 25 nëntor 2024, në brigjet e Antarktidës

Shumica e të dhënave të botës udhëtojnë përmes kabllorve oqeanike që janë në rrezik të sabotimeve të shpeshta. DW shpjegon se ku shtrihen dhe si mbrohen. Një varg sulmesh sabotazhi mbi kabllot nënujore, të kryera nga një “flotë hije” ruse, kanë treguar se infrastruktura globale e telekomunikacionit është e mbrojtur dobët nga aktet e qëllimshme të shkatërrimit.

Lloje të ndryshme kabllorsh nënujore

Disa kabllor nënujore transportojnë rrymë direkte të tensionit të lartë (HVDC) - energji elektrike - në distanca të gjata, si midis ishujve ose vendeve. Këto kabllor gjithashtu mund të lidhin turbinat e erës në det të hapur me vendet në tokë.

Pastaj janë kabllot e telekomunikacionit. Ata transmetojnë rreth 95% të trafikut global të të dhënave, duke përfshirë kërkimet në internet, blerjet në internet dhe thirrjet telefonike - megjithatë, me një vonesë të lehtë sinjali: Thirrja e një uebsajti amerikan nga Evropa zgjat rreth 60 milisekonda.

Përveç kësaj, disa kabllor lidhin qendrat e të dhënave dhe nyjat e mëdha të rrjetit, si dhe ato për komunikim ushtarak dhe kërkime, të cilat janë më të mbrojtura se kabllot e tjera.

Satelitët nuk janë alternativë ndaj kabllorve nënujore

Vetëm një pjesë e komunikimit ndërkombëtar kalon përmes satelitëve - kabllot nënujore mund të transmetojnë shumë më tepër të dhëna me një kosto më të ulët.

Lidhjet satelitore janë më të ngadalta dhe më të ndjeshme ndaj ndërhyrjeve.

Megjithatë, SHBA dhe BE po investojnë në teknologjitë satelitore, të tilla si “Starlink” dhe programi IRIS (Infrastruktura për Rezistencë, Ndërlidhje dhe Siguri nga Sateliti), për të krijuar kanale komunikimi më të sigurt dhe alternative.

Ku shtrihen kabllot nënujore?


Në mbarë botën, ka rreth 500 linja, të përbëra nga 1.4 milion kilometra kabllor. Kabllot janë aq të gjata sa mund të mbështilleshin rreth ekuatorit 30 herë. Kabllot e reja shtohen çdo vit.

Shumica e lidhjeve kabllorë janë të vendosura në Atlantik midis Evropës dhe Amerikës së Veriut dhe në Paqësor midis SHBA-së dhe Azisë Lindore. Megjithatë, nuk ka asnjë atlas të plotë global që tregon vendndodhjen e saktë të çdo kabllorje.

Platforma të tilla si “submarinecablemap.com” ose “TeleGeography” ofrojnë harta, por pa informacion të saktë të vendndodhjes.

Rreth 90% e trafikut të të dhënave midis Evropës dhe Azisë

Kabllot nënujore: Thembra e Akilit e botës sonë dixhitale



detit të thellë dhe sigurojnë një jetëgjatësi prej rreth 25 vjetësh.

Kabllot e mëdha nënujore me një diametër prej më shumë se 20 cm, mund të peshojnë midis 40-70 kilogramë për metër.

Si vendosen kabllot nënujore?

Gjeologët dhe inxhinierët përcaktojnë vendndodhjet më të mira për kabllot, duke marrë parasysh pengesat, të tilla si llogore, rrymat e oqeanit, zonat e peshkimit dhe rrugët e transportit detar.

për shkak të presionit ekstrem nënujor dhe kushteve të paparashikueshme të motit.

Në varësi të dëmtimit dhe thellësisë së kabllor, zhytësit mund të riparojnë kabllot në dhoma të thata, ose një anije riparimi kabllorsh e ngre me kujdes në sipërfaqe.


Në bord, teknikët zëvendësojnë seksionet e dëmtuara me të reja. Pas testimit të gjerë, kabllorja futet me kujdes dhe vendoset përsëri.

Si mund të mbrohen kabllot nënujore?

Kabllot nënujore janë të mbrojtura mirë nga kërcënimet natyrore, por shpesh janë të mbrojtura në mënyrë joadekuate kundër dëmtimit të qëllimshëm nga shtetet armiqësore, agjencitë e inteligjencës ose terroristët.

Dronët nënujorë dhe sistemet e sensorëve akustikë mund të ndihmojnë në zbulimin e akteve të mundshme të sabotimit në një fazë të hershme.

Disa shtete po zhvillojnë strategji të koordinuara të mbrojtjes, me bashkëpunim të ngushtë midis shteteve, operatorëve kabllorë nënujorë dhe organizatave ndërkombëtare. Ekspertët po bëjnë thirrje për një kornizë të re ligjore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, veçanërisht për rastet e luftës.



kalon përmes 14 kabllorve në brigjet e Jemenit. Në vitin 2024, rebelët Houthi sulmuan tre linja të dhënash me një anije mallrash të rrëmbyer në rajon.

Kush i vendos kabllot nënujore?

Në të kaluarën, ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit, si AT&T dhe “China Telecom”, dominonin tregun dhe pronësinë e kabllorve nënujore.

Tani, janë kompanitë e mëdha të teknologjisë si Google, Microsoft, Meta dhe Amazon që investojnë shumë në kabllot nënujore.

Google zotëron gjashtë kabllor aktive nënujore dhe planifikon të ndërtojë më shumë.

Meta ka aksione në 16 kabllor ekzistues dhe planifikon të krijojë rrjetin e saj global.

Si ndërtohen kabllot nënujore?

Kabllot moderne nënujore përbëhen nga disa shtresa të fibrave optike që përdorin impulse drite për të transmetuar informacionin dixhital.

Ato janë të rrethuara nga shtresa mbrojtëse prej teli çeliku ose armaturë çeliku, polietileni dhe materiale të papërshkueshme nga uji. Këto mbrojnë kundër presionit dhe kushteve ekstreme të

Në Detin e Veriut dhe Detin Baltik, rreth 1.6 milionë tonë municione të hedhura nga luftërat e kaluara përbëjnë gjithashtu një sfidë të madhe.

Në ujërat më të thella, deri në rreth tetë kilometra, rreziku i dëmtimit është më i ulët. Kabllot shpesh vendosen direkt në shtratën e detit me mjete speciale për vendosjen e kabllorve.

Kabllorja duhet të jetë e tendosur gjatë procesit të shtrimit. Nëse ka shumë pak tension, mund të krijohen sythe në kabllor. Megjithatë, nëse kabllorja është shumë e tendosur, mund ta bëjë kabllon të notojë dhe të thyhet.

Si dëmtohen kabllot nënujore?

Shumica e dëmtimeve në kabllot nënujore shkaktohen nga rrjetat e tratave dhe spiranca. Por ato dëmtohen gjithashtu nga aktet e qëllimshme të sabotimit: Sulmet e luftës hibride janë të njohura që nga Lufta e Ftohtë. Që në vitin 1959, amerikanët akuzuan rusët për dëmtimin e qëllimshëm të një kabllorje nënujore me rrjeta peshkimi.

Spiunazhi është gjithashtu një problem i madh, pasi kabllot nënujore mund të përgjohen për të dhëna.

Si riparohen kabllot nënujore?

Riparimi i kabllorve nënujore është një proces i ndërlikuar





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Veprimet luftarake në front ishin të ashpra. Forcat e skalionit të parë të DVIS po ndesheshin me vështirësi të shumta. Shtabi i divizionit në fund të janarit 1945, për mungesë të municionit, nxori nga luftimi BrVIS dhe BrXXIIS. Në mësymje drejt Vishegradit u nis BrVIIIS, ndërsa BrVIIS mori detyrë të vazhdonte mësymjen drejt Vishegradit. Bashkëveprimi midis tyre bëri që të ndërpriste hekurudhën Vishegrad-Megjegja dhe u vështirësoi gjermanëve tërheqjen për në Sarajevë. BrVIIIS në zbatim të detyrës i vazhdoi sulmet kundër armiqve dhe i dëboi ata nga fshati Strezhenica që ishte pranë Vishegradit.

Shtabi i divizionit, më 3 shkurt 1945, urdhëroi sulmin përfundimtar për çlirimin e Vishegradit. Fillimisht forcat partizane do kryenin veçimin e nazistëve, ndërprerjen e komunikacionit hekurudhor të Vishegradit dhe asgjësim të tyre, çlirimin e Vishegradit dhe mos shkatërrimin e urës mbi Drina. Në sulm do merrnin pjesë: në krahun e djathtë BrVIIS me objektiv Suhagorë-Vishegrad; në qendër BrVIIIS me objektiv Drinsko-Vishegrad; në krahun e majtë BrVIS (dy batalione) me objektiv hekurudhën Vishegrad-Megjegja, ndërsa në të djathtë të BrVIIS do mësynte Brigada V e Sanxhakut.

Në mëngjesin e 5 shkurtit nisi sulmi i menjëhershëm në të gjitha drejtimet. Luftimet e ashpra bënë që armiku të lëshonte pozicioneve duke e ngushtuar më shumë rrethimin e Vishegradit. BrVIIS u ndesh me armiq të në kodrat e fshatrave Zaçe e Zanosha dhe në pjerrësitë perëndimore të Suhagorës, për çdo sulm, vinte dhe një kundërsulm armik. Pozicionet e luftimit në datat 5-6 shkurt kalonin nga sa nga partizanët ashtu dhe të armikut. Sulmi më i ashpër vazhdoi deri në çdo togë, duke mbajtur pozicionet në mënyrë demonstrative, u hodhën në një sulm vendimtar me baza togat partizane në të gjitha drejtimet.

BrVIIIS bashkërendoi veprimet me BrVIIS, sulmoi dhe mori Pjavicën e fshatra të tjera në anën e djathtë të Drinas pranë Vishegradit.

BrVIS goditi me zjarrin e mitralozave forcat naziste që lëviznin dhe mbroheshin në hekurudhë. Në përleshje me nazistët objektivi u arrit.

Luftimet vazhduan me ashpërsi, me sulme e kundërsulme, me përparime e zmbropsje nga të dy palët. Luftimet më 5-6 shkurt pranë Vishegradit ishin nga më të përgjakshmet. Në luftime ranë 16 luftëtarë të BrVIIS, 17 luftëtarë të BrVIIIS, 12 luftëtarë dhe 25 të plagosur të BrXXIIS. Ditë më pas vdiqën nga plagët 7 luftëtarë të tjerë të BrVIIS. Të plagosur nga brigadat ishin mbi 54 luftëtarë.

Shtabi i DVIS në javën e dytë të shkurtit, kishte mungesë të municionit dhe ishte në vështirësi për të vazhduar mësymjen për çlirimin e Vishegradit. Në këto kushte vazhdonin luftimet në front BrVIIIS e BrXXIIS, ndërsa BrVIS me BrVIIS u zhvendosën në prapavijë.

Në datat 7-12 shkurt BrXXIIS dhe BrVIIIS zhvilluan sulme kundër pikëmbështetjeve armike përreth Vishegradit. Këto sulme e mbanin armikun vazhdimisht nën presion duke e detyruar atë të lëshonte pozicione. Më 8 shkurt, luftëtarët e BrVIIIS sulmuan dhe pas luftimesh zuri pozicionet e gjermanëve në fshatrat Han, Pjavić, Uznovica e Mirdović, duke u afruar më shumë afër qytetit.

Në mëngjesin e 13 shkurtit, shërbimi i zbulimit njoftoi se komanda gjermane kishte vendosur të braktiste Vishegradin dhe kishte zhvendosur vijën e frontit në veri, drejt Sarajevës. Shtabi i DVIS urdhëroi BrXXIIS dhe BrVIIIS të sulmonin dhe të hynin brenda në qytet në bashkëveprim me partizanët jugosllavë, duke synuar shpërndarjen e autokolonave gjermane në tërheqje dhe asgjësimin e tyre.

Brigadat partizane në përparim drejt Vishegradit, morën pikëmbështetjet në kodrat në jug e juglindje të qytetit, ku për 15 ditë rresht forcat e UNÇSH-së kishin zhvilluar luftime të ashpra. Në mbrëmje pararojat e BrXXIIS e të BrVIIIS u gjendën në portat e Vishegradit. Në mëngjes të 14 shkurtit, BrVIIIS sulmoi armiq të brenda në qyteti. U zhvilluan luftime të cilat nuk zgjatën shumë. Armiku u tërhoq përtej Drinas, duke shkatërruar urën e madhe. Brigadat partizane kapërcyen lumin dhe goditën gjermanët në pjesën tjetër të qytetit. Në mesditë të 14 shkurtit qyteti ishte spastruar nga pushtuesit nazistë. Në Vishegradin e lirë ndodheshin forcat e DVIS të UNÇSH-së dhe të Brigadës V të Sanxhakut. Për çlirimin e Vishegradit dhanë jetën 119 luftëtarë të UNÇSH-së, 48 luftëtarë të BrVIIS, 30 luftëtarë të BrVIIIS, 29 luftëtarë BrVIS, 12 luftëtarë të BrXXIIS, si dhe pati më shumë se 200 luftëtarë të plagosur.

Armiq të tërhequr nga Vishegradi, gjendeshin rreth 2-3 km larg tij dhe goditnin vazhdimisht me artileri qytetin dhe fshatrat. BrVIIIS ndenji vetëm dy-tri ditë brenda në Vishegrad. Qyteti ishte

BETEJA PËR ÇLIRIMIN E VISHEGRADIT



i shkatërruar dhe gjithandej i minuar, popullsia e kishte braktisur. BrVIIIS kishte marrë detyrë të pastronte qytetin nga minat, por për mungesë të specialistëve të mjaftueshëm dhe se artileria gjermane qëllonte pa pushim, nuk mundi ta kryente këtë detyrë.

Forcat e DVIS, të cilat kishin marrë udhëzim nga shtabi i forcave jugosllave që të mos kalonin lumin Drina, qëndronin përballë armikut dhe ndiqnin me kujdes gjithë veprimet e tij, duke kufizuar sa më shumë lëvizjet për të mos u goditur nga artileria gjermane, që nuk rreshte së hedhuri predha në rajonet e vendosjes së tyre. Prej disa ditësh DVIS kishte vendosur lidhje me DVS të UNÇSH-së, që ndodhej në rajonin e Novi-Pazarit. Kuadro e partizanë, të gjithë ishin të mobilizuar e të përgatitur shpirtërisht për të vazhduar më tej luftimet me ushtrinë naziste në drejtim të Sarajevës. Shtabet e DVS e të DVIS i kishin kërkuar Komandës së Përgjithshme të UNÇSH-së që të ndërhynte pranë Shtabit të Përgjithshëm jugosllav për zgjidhjen e problemit, të furnizimit me municione e veshmbathje nga i cili kushtëzohej vazhdimi i mëtejshëm i luftimeve kundër ushtrisë gjermane në Jugosllavi. Mirëpo shtabi i Titos e kishte bllokuar me qëllim këtë zgjidhje.

Në kohën kur kuadrot e partizanët e DVS e të DVIS prisnin të furnizoheshin me municione për të vazhduar ndjekjen e ushtrisë gjermane drejt Sarajevës, shtabet e tyre, më 24 shkurt, morën urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm jugosllav që të grumbullonin të gjitha forcat në Novi-Pazar, Mitrovicë e Vuçiternë, për t'u kthyer në Shqipëri. Shtabet e divizioneve njoftuan menjëherë me radiogram Komandën e Përgjithshme të UNÇSH-së në Tiranë për urdhrin e marrë, duke i raportuar dhe për mungesën e municionit e të veshmbathjes.

Gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake të divizioneve shqiptare në këto krahina, furnizimi me ushqim e veshmbathje u krye nga intendencat e divizioneve e të brigadave, nga vendvendosja e tyre. Për këtë ato shfrytëzuan rezervat e krijuara gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake. Për të siguruar ushqimin e trupave u përdorën fondet monetare e të njëjseve, me të cilat u blenë sende ushqimore në krahinat ku vepronin njësitë. Veç kësaj, populli u dha partizanëve edhe ushqime vullnetarisht dhe pa shpërblim. Për dhënien e ndihmës mjekësore për të plagosurit rëndë e të sëmurët, divizionet përdorën spitalet e tyre dhe ato të vendit, kurse për të plagosurit lehtë ndihma mjekësore u dha drejtpërdrejt në front me forcat e mjetet e brigadave. Kryerja e veprimeve në një mjedis të panjohur, kundër një armiku që tërhiqej duke u mbrojtur nga një vijë në një vijë tjetër dhe në kushte të vështira atmosferike, shtroi përpara shtabeve të divizioneve e të brigadave detyrën e organizimit të një zbulimi të vazhdueshëm.

Por problemi që mbeti gjithmonë në qendër të vëmendjes së shtabeve ishte furnizimi me municion. Rezervat e municionit gjithnjë ishin të pakta, aq sa shpeshherë për vijimin e veprimeve luftarake të batalioneve të skalionit të parë u përdorën municionet që u merreshin atyre që qëndronin në skalionin e dytë. Në raste të veçanta, për të siguruar municion, u përgatitën grupe partizanësh që futeshin në befasi në prapavijat e armikut, sulmonin garnizonet gjermane, u

rrëmbejnë atyre municion dhe ktheheshin me shpejtësi në repartet e tyre. “Gjatë luftimeve, - raportonte shtabi i BrVIS, - na u mbaruan fishekët... krijuam disa grupe të vogla sulmi, të cilat i dërguam në prapavijat e armikut me detyrë të na siguronin fishekë”.

Njësitë e UNÇSH-së, që luftuan për çlirimin e popujve të Jugosllavisë krahas heroizmit masiv e shpirtit të madh internacionalist, treguan dhe mjeshtëri të lartë ushtarake në luftime e beteja. Këto cilësi ata i kishin fituar në përleshjet e përgjakshme për çlirimin e popullit dhe atdheut të tyre.

Gjatë këtyre veprimeve, sulmi kundër armikut në tërësi u bë në kushte të vështira atmosferike. Qendrat e zjarrit të armikut u sulmuan me granata dore në befasi, në afërsi dhe nga drejtime ku terreni ishte i vështirë dhe armiku nuk kishte marrë masa të fuqishme për mbrojtje. Kompanitë dhe skuadrat partizane iu afruan nga krahët qendrave të zjarrit të armikut, dhe pasi hidhnin mbi to granatat e dorës, sulmonin me shpejtësi.

Bashkëveprimi i njëjseve partizane me forcat jugosllave gjatë zhvillimit të këtyre operacioneve nuk u organizua, për arsye se komanda e Korpusit II Jugosllav, si komandë më e lartë që vepronte në këto krahina, nuk e kreu këtë detyrë. Ajo u mjaftua vetëm me largimin e forcave të veta nga fronti, për të futur në luftë brigadat sulmuese të UNÇSH-së, duke u caktuar këtyre drejtimet më të forta të mbrojtjes armike. Edhe veprimet luftarake të tyre nuk i ndihmuan veprimet luftarake të divizioneve shqiptare. Po qe se njësitë e divizioneve XXII dhe XXXVII jugosllave do t'u kishin ndërprerë forcave gjermane rrugën e vetme të tërheqjes Prijeplje-Priboj dhe Kolashin-Plevlje, ato do të ishin rrethuar dhe asgjësuar, duke i lehtësuar operacionet e divizioneve shqiptare në Malin e Zi dhe në Sanxhak.

Shtabi i DVIS i raportonte Komandës së Përgjithshme të UNÇSH se “...krahinat Buzro, Rudo, Dobrun e Vishegrad janë çliruar nga thonjtë e okupatorit e të çetnikëve nga forcat e DVIS. Forcat jugosllave vijnë në këto krahina pas lufte e prapa nesh”. Nga shtabet e divizioneve dhe të brigadave partizane u bënë të gjitha përpjekjet për të bashkërenduar veprimet me forcat jugosllave. Ato ishin porositur që me mbërritjen në rajonin e veprimit “...menjëherë të kërkonin kontakt me shtabet e UNÇJ që ndodheshin aty. Veprimet, - u theksohej njëjseve partizane, - do të bëhen të kombinuara dhe planet do të studiohen së bashku”. Veç kësaj, urdhrat e operacioneve të divizioneve shqiptare iu janë dërguar edhe komandës së Korpusit II të UNÇJ.

Brigadat e DVS dhe të DVIS të UNÇSH-së, pasi zhvilluan edhe disa muaj luftime kundër bandave çetnike u kthyen në Shqipëri në javën e parë të dhjetorit të vitit 1945. Në luftë me pushtuesit gjermanë dhe veglat e tyre përtej kufijve shtetërorë në Jugosllavi dhanë jetën mbi 600 luftëtarë të UNÇSH. Popujt vëllezër të Malit të Zi, Vishegradit, të Kosovës dhe të Bosnjës Jugore s'do t'i harrojnë kurrë bijtë dhe bijat e popullit shqiptar që luftuan me vetëmohim për çlirimin e popujve të Jugosllavisë.

Profesor Milto Vako u lind në Pogradec në 30 mars 1930. Pasi mbaroi shkollën 7-vjeçare në vendlindje, i del e drejta për studime në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Duke qenë skënderbegas, dërgohet si kontigjent i Ministrisë së Mbrojtjes për të ndjekur shkollën e mesme artistike “Jordan Misja” të cilën e përfundon në vitin 1952. Gjatë kësaj periudhe, në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” ai ka dhënë një kontribut të çmuar në aktivitetet muzikore, duke bërë emër si një muzikant i talentuar dhe me të ardhme. Nga viti 1953- 1959 vijoi studimet e larta në Konservatorin “Çajkovski” në Moskë, ku diplomohet si dirigjent kori, me profesorin e famshëm Sokollov. Në Moskë, bashkë me ‘të ishim dhe 5-6 studentë, mjeshtrat e njohur të muzikës shqiptare si Luk Kaçaj, Çesk Zadeja, Tish Daija, Rifat Teqja. Pas studimeve u emërua dirigjent në Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, njëkohësisht pedagog në ILA dhe në liceun artistik. Nga 1964- 1968 punoi si dirigjent në TOB. Në 1968- 1973 udhëheqës artistik i AKVP.

Profesor Vako renditet ndër themeluesit e Konservatorit Shtetëror të Tiranës, ku së bashku me figura të tjera të njohura si A. Paparisto, Ç. Zadeja, H. Stringa, M. Krantja, etj, i dhanë jetë shkollës së lartë të muzikës në Shqipëri. Në 1973 dënohet, largohet nga AKVP dhe internohet në Tepelenë, ku punoi për dy vjet rresht

SKËNDERBEGASI MILTO VAKO, profesori me gjurmë të arta të muzikës shqiptare



në kushte të vështira. Në 1975 arrestohet dhe dënohet për agjitacion e propagandë. Vuan dënimin në burgun e Tepelenës e në Ballsh deri në vitin 1982. Pas burgut, deri në vitin 1990 punon si punëtor në ndërmarrjen e Mirëmbajtjes së Shkollave të Tiranës. Në vitin 1990 kthehet pedagog në Akademinë e Arteve. Ndërsa nga viti 1993-2001 ishte shef i katedrës së kantos e dirigjimit. Nga 2001 është pedagog i katedrës së kantos dhe dirigjimit. Ka themeluar dhe drejtuar koret e vajzave në Akademinë e Arteve si dhe korin e Kishës. Ka dhënë me dhjetëra koncerte si brenda e jashtë vendit, ku është nderuar me çmime të ndryshme.

Profesor Milto Vako, është dhe autor i disa librave për muzikën si “Krijimtaria korale”, “Puna me korin dhe teknika vokale”, “Teoria e solfezhit dhe e harmonisë”, etj... Ai është autor i shumë teksteve dhe mban titullin profesor, si dhe “Artist i Merituar”.

Dirigjenti Milto Vako, ndërron jetë në moshën 90-vjeçare duke lënë pas gjurmë të arta në muzikën shqiptare.

RAZI BRAHIMI, personalitet i letrave shqipe



Razi Brahimi ish-kritik, ish- pedagog e dekan në Institutin e Lartë të Arteve, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, qysh në krijimin e saj dhe një nga nxënësit e suksesshëm të Shkollës Ushtarake “Skënderbej”.

Razi Brahimi lindi më 9 maj 1931 në Delvinë dhe nuk është e vështirë që, aty për aty dhe me pak fjalë, të shpjegosh se përse çdo shqiptari, po t’i përmendësh emrin e tij, do t’i ndërmendet menjëherë emërtimi: kritik letrar. Ose dhe e kundërta: kritiku letrar shqiptar të kujton menjëherë Razi Brahimin. Mendoj se kjo ka të bëjë me atë se: Për së pari institucionalisht, ata lindën bashkë... Historia e mendimit estetik shqiptar është e hershme. Ajo njeh personalitete të shquara të artit dhe shkencës që kanë shprehur, aty këtu, nëpër organe të ndryshme shtypi, seriozë për kohën, mendimet e tyre estetike, si: Naim e Sami Frashëri, Fan S. Noli, Faik Konica, Mitat Frashëri, Eqrem Çabej, Kostaq Cipo, Mitrush Kuteli, Skënder Luarasi, Dhimitër Shuteriqi, Nonda Bulka e ndonjë tjetër. Trashëgimia e tyre është një thesar i pamohueshëm dhe shumë i çmuar për letërsinë shqipe, por gjithsesi ato, në më të shumtën e rasteve mbeten shkrime (për qëllime të ndryshme) me mendime estetike, apo qëndrime kritike në kuadrin e artikujve të publicistikës. Rrallë mund të gesh ndonjë shkrim që të quhet kritikë e mirëfilltë profesioniste, si për shembull debati “A është poet Lasgush Poradeci?” midis Krist Malokit dhe Kutelit, botuar tek revista “Përpyekja shqiptare” e Branko Merxhanit në vitet ‘30 të shekullit XX.

Historia si datë lindjeje të “kritikës letrare”, si një zhanër më vete, në kuptimin e saj të mirëfilltë në Shqipëri, ashtu si edhe për shumë gjini të tjera të artit si teatri, opera, baleti, kinematografia,... do të njohë vetëm vitet ‘50 – ‘60 të shekullit XX. Në këtë këndvështrim, historia e letërsisë shqipe, do t’i njohë Prof. Razi Brahimit kontributin e pamohueshëm si një ndër të parët, në mos i pari, që vendosi në ato mote gurrët e themelit të institucionit të kritikës letrare. Kritiku Razi Brahimi dhe kritika e jonë letrare janë vërsnikë. Gjithashtu letërsia shqipe, veç librave të shumtë me studime letrare dhe kritikë, do ta njohë Razi Brahimin edhe si poet, tregimtar, novelist dhe romancier, por ajo që ai nuk e “tradhtoi” gjer më sot, mbeti kritika. Këtu mund të ndalemi dhe të perifrazojmë një thënie të vetë kritikut tonë që i provoi të gjitha zhanret e letërsisë: “Kritikët e vërtetë janë verë e thartuar, domethënë si ajo uthulla që përftohet si e tillë, pasi enkas nuk i është ndërprerë fermentimi verës...” – thotë ai. Si një verë e vjetër e cilësisë më të lartë, e transformuar qëllimshëm në “uthullën” e munguar në sofrën e letërsisë shqiptare, antikonformist si ai,

kritiku Razi Brahimi, vazhdon ta mbajë fort stafetën e vendit të parë. Dy esetë e tij të përmbledhura në një libër: “Adresa e poetit Nase Jani” dhe “Çmendina” – një roman ndryshe”, flasin për vëmendjen e studiuesit të vërtetë që vëzhgon me përgjegjësi atdhetare, fatin e shkrimtarëve seriozë që krijojnë në mërgim. Qëmtun dhe evidenton me kompetencën e profesionistit të rrallë çdo vlerë të këtij krijuesi të veçantë... Eseja brilante “Na mungon Migjeni”, që na dhuroi së fundmi Razi Brahimi, veç vitalitetit fizik, dëshmon edhe për vitalitetin e mendimit kritik shqiptar, që e mban me të drejtë kritikun tonë, jo vetëm si një gur të çmuar themeli në letërsisë bashkëkohore shqipe, por edhe si mendimtarin më të fuqishëm në raport me aktualitetin.

Razi Brahimi lindi më 9 maj dhe kjo datë përkon edhe me Ditën e Fitores mbi fashizmin. Vetëm një intelektual antifashist i lindur, human e trim si ai, mund të thotë troç: “Për të ecur me sukses në rrugën e shkrimtarëve misionarë shoqërorë, duhet përveç talentit dhe zotërimit të mjeshtërisë së fjalës artistike, burrëria për ta thënë

hapur dhe pa ekuivoke e konformizëm mendimin dhe për t’i dhënë në dorë shoqërisë, pasqyrën për të parë vetveten lakuriq. I kërkohet shpengim prej censurës së tregut, e cila në vend të orientojë, çorienton si përmbushëse oreksesh të parallinjve dhe të atyre që kanë interes të trullosin lexuesit me eksitantë cilësish të dyshimta e t’u japin vlerë të pamerituar mediokritetit, vulgaritetit e banalitetit, lektisjeve erotike, përfytyrimeve të kllapishme e fantazmagorike, arratisjeve në sfera spekulimesh pseudofilozofike apo ngujimesh në subjektivizëm të skajshëm individualistësh e egoistësh, të cilët rrihen të zënë vendin e heroit tipik të kohës.”

Dosjet e tij me mijëra fletë të daktilografuara, që shtohen çdo ditë nga i palodhuri Razi Brahimi, janë pasuri e kulturës kombëtare dhe duhet të gjejnë sa më parë dritën e botimit. Me këtë krijimtari të begatë, plot shëndet edhe vital, me shembullin e tij “babai i kritikës shqiptare” që këtë 9 maj mbush 84 vjeç, jep një mesazh të madh dhe u thotë më të rinjve: “Stafeta nuk dorëzohet. Ajo rrëmbehet. Ejani në garë dhe provojeni ta rrëmbeni! Unë Razi Brahimi s’kam ndërmend ta ndal vrapin...”

Me librin e tij “Vetëvrasje poetësh”, duke portretizuar si një mjeshtër që do ta kishin zili edhe kritikët bashkatdhetarë të Pushkinit, Eseninit, Majakovskit dhe Fadajevit, për të cilët flitet aty, kritiku ynë Razi Brahimi, bën edhe një radiografi shumë interesante të sistemit shoqëror dhe të “sëmundjeve” të kohës kur jetuan poetët e sipërpërmendur... Me stilin e një mjeshtri që është plakur duke shkruar, me guximin e një intelektual si ai, mendimtari Razi Brahimi trajton me realizëm mjerimin shpirtëror, degradimin dhe degjenerimin moral tek artisti. Në libër u jepet përgjigje pyetjeve që shkaktuan pendesën, brejtjen e ndërgjegjes, krizën psikologjike dhe vetëvrasjen e tyre. Tema këto, krejt të virgjëra për lexuesit shqiptarë. Në fund të parathënies së këtij libri të rrallë, autori ynë thotë: ...”Vetëvrasje poetësh”, siç e besoj se do të vërehet prej lexuesve, është një libër i shkruar në kohën kur autori është “me një këmbë në yzengji”, por mendimet e shfaqura në të mbajnë vulën e një tridhjetëvjeçari që nuk e pranonte vetëvrasjen dhe aspironte e besonte në një rend shoqëror, në të cilin rrethanat bëhen aq njerëzore, sa i sigurojnë hapësirë të lirë jete e zhvillimi çdo individualiteti.”

Studiuesi dhe shkrimtari Razi Brahimi ndërroi jetë në Tiranë pas një sëmundjeje të rëndë në moshën 84-vjeçare.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MBROJTJES



WeAreNATO.MbrojtjaShqipërialme.ForcatEArmatoesura.FA.KrenariKombëtare